

KOZMARIJA

Ballina: Shkendije Berisha-Pacolli
Foto: Norik Uka

Në Kosovë
do të mbesin
vetëm politikanët

Pse rrahje
e vrasje
çdo ditë
në Kosovë

**SHKENDIJE
BERISHA-
PACOLLI:**


*Të mahosh origjinën
e mahon vetveten!*

Çili këngëtar yni
rrenë
më së shumti

Të panjohurat
e prezantuesve
tona

Këngëtarët tanë
që u martuan
jo vetëm një herë

UB, urë bashkëpunimi
me ndërmarrjet
nga Kosova





Koleksioni
**MIRAGE
JW 12 LUC**

**DIMENSIONI:
160X320**

 **DINO
QERAMIKA**

Në cilin vend mund ta largoni gripin e Prishtinës?

Për ju që jeni mbushur monotoni, tym duhani e zhurmë, papunësi e nervozizëm apo edhe grip Prishtine të këtij dimri, revista jonë sjellë relaksim nga ambienti i rrallë malor, Bjeshkët e Nemuna, me të vetmit banorë të përhershëm: arinjtë, ujqit, derrat e egër dhe dhelprat, kurse njerëzit në këto anë, paksa më shumë, mund t'i shohësh kryesisht vikendeve, kur edhe dalin për të shëtitur...

"Këto ditë të mesdimrit Rugova u zbardh nga bora, meqë deri para pak ditësh natyra dukej si në vjeshtë", thotë bashkëbiseduesit, sepse trashësi

bore sivjet nuk ka pasur në këto anë, e që veçohen për borë të dendur dhe që qëndron gjatë...

KU JANË NJERËZIT?

"Në gjatësinë 23 kilometra Pejë-Kuçishtë, rruga është e shtruar me asfalt, por njerëzit kanë ikur", më thotë Sefa, 71 vjeç, nga Peja, i cili edhe më përshëndeti në vendin "Te pishat e Leçinatit", ku edhe kishte dal nga vetura të shihte bukuritë madhështore të kësaj ane.

"Dola në këtë anë të mbushem me ajër Rugove. E sheh edhe vetë se rrallë mund të hasësh në njerëz, e jo si dikur kur Rugova ishte e mbushur me njerëz me plisa e shall rugove, me barinj e gra që kujdeseshin për bagëtitë... Por, kur mendon paksa më ndryshe, vështirë e kanë pasur, sepse gratë, veçmas, kanë hequr shumë me punë të rënda e bagëti, duke i mbledhur në mbrëmje kodër më kodër... Tash banorët, e që dikur jetonin këtu, kryesisht, jetojnë në Pejë, kurse në qytet jeta është shumë më e lehtë, më ndryshe...

Natyre e bukur po, por si në xhungël, sepse njerëz pak ka, kafshë asnjë, e

kafshë të egra po. Derrat e egër i kanë "lëvruar" oborret e shtëpive, sepse shëtisin shlrirë, meqë natën nuk ka njerëz në këto anë", thotë Sefa.

VETËM NË BOGË KA GJALLËRI...

Aty ku rrjedh ujëvara, te tuneli i parë, nuk ka më shitës si gjatë verës, e të cilët krijojnë gjallëri. Një mbishkrim te ura: "Ndalohet gjuajtja e troftës!", të jep të kuptosh se ka ligje edhe në këto anë, e që mund të dënohet njeriu po qe se gjuan peshq.

Dimrit nuk ka njerëz as në Drelaj.

Vetëm te restorantet vërehen lëvizje të njerëzve. E vetmja figurë e njeriut në bronz është ajo e kaçakut Sali Rama, ku njerëzit verë e dimër pinë ndonjë gëllënkë ujë të ftohtë.

Në fshatin ku edhe degëzohen rrugët për në Çakorr, vetëm pak rrugë pranë kufirit, duken shtëpitë e reja të Kuçishtës, lumi, "Mulliri i Isufit" dhe asgjë më shumë...

Sidoqoftë, një relaksim të mirë dhe të rrallë njeriu e gjen vetëm në Bjeshkët e Nemuna, aty ku nuk ka vend as gripi e as monotonia...

Safet Krivaça



“N’Peshk Terrace” zyrtarisht në mesin e top tre restauranteve më të mira në Kosovë



“N’Peshk Terrace” është adresa e preferuar e të gjithë atyre që bëjnë përherë zgjedhje të duhura kur është fjala për ushqime deti.

Restauranti është i njohur për produktet më të freskëta të ushqimit të detit në Kosovë.

Gatimet dhe servirja janë aq mbreslënëse, sa që të kthehen në fiksime dhe kjo është arsyeja që restorantin ka një klientelë të madhe që e viziton.

“N’Peshk Terrace” ofron lloje të ndryshme dhe speciale të pjatave, nga ato që mund ti gjeni vetëm aty dhe në asnjë vend tjetër.

Jo rastësisht “N’Peshk Terrace” tashmë gjendet edhe zyrtarisht në listën e top tre restauranteve më të mira në Kosova.

“N’Peshk Terrace” me çiftin e kuzhinierëve Aleksin dhe Klaudian, kanë fituar vendin e dytë në garën e kuzhinierëve të organizuar nga “Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës” (OHTK).

Kjo garë si e tillë është organizuar për herë të parë në Kosovë.

Të kujtojmë që në këtë restorant ekekskluziv peshku që gjendet në Prishtinë, organizohet edhe evente me ushqime të freskëta deti në një ambient që i ofron të gjitha, duke nisur nga pamja, komoditeti, privatësia dhe shërbimi ekselent.



remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja
Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Në kontaktoni në info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de



Dhoma në bunker e Enver Hoxhës

Si u frymëzua Enver Hoxha nga Koreja e Veriut?

Gazetarja e BBC, Bettany Hughes, ditë më parë e ka vizituar bunkerin e ish-diktatorit Enver Hoxha.

Në kuadrin e rubrikës “Mrekullitë e Shqipërisë” në “BBC World”, Hughes ka bërë një dokumentar dedikuar bunkerit poshtë vilës së ish-diktatorit Enver Hoxha, që ishte ndërtuar për të përballuar edhe një luftë nukleare. Ajo hynë edhe brenda dhomës personale të Enver Hoxhës dhe tregojnë se për një pjesë të bunkerit ish-diktatori ishte frymëzuar nga Koreja e Veriut.

BUNKERI PESËKATËSH NËN TOKË - POPULLI JETOI ME RRISKA BUKE!

Gazetarja nuk lë pa theksuar se nën regjimin e Enver Hoxhës shqiptarët

ishin populli më i varfër në botë. “Ky është bunkeri sekret më i madh në të gjithë vendin. Është të paktën 5 kate nën dhé dhe qëllimi i tij ishte të përballonte sulmet kimike dhe nukleare. Janë qindra dhoma në këtë bunker, me qëllime të ndryshme. Aty ndodhen dhomat e dekontaminimit, apo ato për komandantët e ushtrisë dhe, pastaj, është një kinema e teatër, vërtet i çuditshëm dhe, gjithashtu, i bukur, ku oficerët do vinin për të marrë komanda dhe për të parë deklaratat publike të qeverisë.

Ideja e gjithë kësaj ishte që nëse një luftë nukleare do të zhvillohej, një

formë e çuditshme e jetës të mund të vazhdonte këtu poshtë”.

DHOMA PERSONALE E ENVER HOXHËS

Dhoma e ish-diktatorit ishte një nga më të sigurtat në bunker, ndërsa projekti i tij është frymëzuar nga një vizitë në Korenë e Veriut.

Bunkerët e krijuar nga ish-diktatori Hoxha nuk qenë të nevojshme asnjëherë, pasi nuk pat asnjë sulm nuklear, por pat vetëm varfëri shkatërruese. Gjatë regjimit të Hoxhës populli shqiptar u bë një nga më të varfrit në botë”, thotë gazetarja.

NË KOSOVË DO TË MBESIN VETËM POLITIKANËT!

Tërë jetën të ndjekë një hije, nga e cila s'mund të largohesh, s'mund as ta lësh. Kjo është vetja jote...



PSE IKIM SOT NGA KOSOVA?

"Ku, kah po shkon, pse po ikë e po e lë Kosovën, familjen, shoqërinë?", këto pyetje para disa vitesh ua bënim qytetarëve, atyre që e lëshonin Kosovën.

E, po të njëjtat pyetje: "Ku, kah po shkon, pse po ikë e po e lë Kosovën?", vazhdojmë t'i dëgjojmë edhe sot, 24 vjet pas luftime!

Cila është arsyeja e migrimit të tyre sot? Cila kategori e njerëzve detyrohen sot të ikin nga Kosova?

Pse?

Pamundësia për të zënë një vend pune, niveli i ultë i standardit për një pjesë të madhe të popullsisë dhe mungesa e perspektivës, siç deklarojnë, janë disa nga arsyet kryesore.

A nuk janë ata "kapitali njerëzor" me të cilët ne sot krenohemi?

Shqetësuese është, madje, ikja e të rinjve me fakultet e master të kryer, të cilët, me të

njëtin kualifikim shkollor, në vende të tjera të botës do të çmoheshin dhe mbiçmoheshin.

Në këtë aspekt, për kokë banori, prinë Gjilani. Në vitin që e lamë pas (2022) nga kjo komunë e braktisën Kosovën 4400 qytetarë!

Por, as në komunat e tjera nuk është më mirë. Nga Prishtina po ikin, madje, edhe specialistët më në zë të shëndetësisë, po ikin edhe motrat mediciane dhe punëtorët e kualifikuar të ndërtimitarisë.

Ndërkaq, studentët që kanë notën mesatare më të lartë po i synojnë universitetet me renome evropiane, por edhe në SHBA dhe nuk kthen më...

Andaj, nëse vazhdon edhe më tutje ky trend i ikjes, në Kosovë do të mbesin vetëm politikanët tanë dhe të afërmit e tyre të privilegjuar.

Keq, a?

*

Shqiptarët janë ndër popujt më të palumtur në botë. Të dëshpëruar dhe pesimistë, sipas Institutit për Kërkime Shoqërore të Universitetit të Meçiganit, si ne, janë: armenët, moldavët dhe zimbabvët.

*

Po të gjendeshe para mbretit, çfarë pamje do kishte fytyra jote?

Kur gjendesh para lypësit, çfarë maske shihet në fytyrën tënde?

Kur gjendesh ulur para gruas e kur para të dashurës, cila pamje e fytyrës sate do të jetë e vërteta?

Pse, në secilën situatë, në secilën pozitë, në fytyrë kemi një maskë të veçantë?

Cila është fytyra jonë?

Cila është fytyra e vërtetë?

Pse maskohemi?

Pse fshihemi?

T'ishte shpirti si bora e bardhë që i mbulon të këqijat?!

Ah, bre!

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Në ballinë: Shkendije Berisha-Pacolli

**SHKENDIJE
BERISHA-
PACOLLI:**
Të mohosh
origjinën
e mohon
vetveten!

Shkendije Berisha Pacolli është lindur në fshatin Pozhar të Deçanit. Shkollën fillore dhe arsimimin e mesëm i kreu në vendlindje, kurse studimet për psikologji në Sllovaki. Pas diplomimit është shpërngulur në Gjermani, ku jeton dhe punon që 26 vjet. Është e martuar dhe nënë e dy vajzave: Leonites (21 vjeçe) dhe Lorenas (12 vjeçe).

“E edukuar dhe e rritur në frymën e pleqnarëve të Dukagjinit, përkatësisht Pozharit, pasardhës të Demë Ali Pozharit, mua si fëmijë më ishte ngulitur në mendje njëra ndër thëniet e tyre se popullin tonë mund ta qojmë përpara me tri gjëra: me pushkë, bukë dhe penë, ose në gjuhën zyrtare: ushtria, ekonomia dhe arsimit. Unë edhe ashtu isha e bekuar me dy prindër mësimdhënës, andaj zgjedhja arsimit, ku edhe sot ajo që më përbushë është leximi dhe studimi i vazhdueshëm, duke kujtuar fjalën e Sokratit se “E di që nuk di asgjë”.

GRUA E FORTË, E PATHYESHME

Shkendije Berisha, femër me arritje në të gjitha aspektet, tregon se qysh në moshën e rinisë, pas leximit të romanit “Sikur t’isha djalë” të Haki Stërmilit, kishte ndjeja të një rebelizmi për luftimin e pabarazisë gjinore.

“Duke arsyetuar bindjet dhe besimet e mia të ngulitura në ndërdijen time nga edukimi, unë, gjithmonë, duke qenë falënderuese për faktin se pata fatin të vazhdoj gjimnazin, prapë heshtja dhe ngushëlloja vizionin tim me vargjet “Sikur t’isha djalë”, e t’i tregoja botës se dora që përkund djepin është dora që përkund fatin e njerëzimit.

Por, jam vajzë dhe si e tillë nuk mun-

dem të nxjerrë zërin, andaj prapë e ngushëlloja veten “Sikur t’isha djalë”. Dhe, duke qenë nga fshati e duke i vazhduar studimet në një metropol si Bratislava, bindja ime se për të arritur diçka në jetë nuk duhet të jesh me doemos djalë, filloi të zbehet”, thotë Shkendija, imazhi i faqes së parë të “Kosovares”.

E inspiruar dhe e frymëzuar nga mësimet psikologjike, me një vizion më të qartë dhe më e vendosur se kurrë më parë, ajo shpërngulet në Gjermani, për t’i vazhduar studimet Master, me qëllimin që të kthehet në Kosovën e saj të dashur, për të kontribuar në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e barazisë gjinore.

E, ÇKA NDODHI?

“Si shumë herë në jetë kur bëjmë plane, atëherë jeta na buzëqeshë me ironi ose, siç thotë John Lennon, “Jeta është ajo që ndodh përderisa ti je i zënë duke bërë plane tjera”.

Sikur edhe shumë shqiptarëve të tjerë, edhe mua në ato vite të vështira që i kaloi populli ynë, planet e mia morën kah tjetër.

Mirëpo, në jetë asnjëherë nuk mund t’i kemi kreyt, ose jo të gjitha në të njëjtën kohë.

Edhe pse në të 40-at i përfundova “obligimet” familjare, arrita një standard të jetesës që as që e kisha ëndërruar.

Por, shpirtërisht nuk isha e plotësuar, se diçka thellë në mua nuk ishte në harmoni me vlerat e mia, me vizionin tim të fëmijërisë dhe, kështu, fillova të pyes veten se çfarë është kjo...

Në atë kohë isha e punësuar 10 vjet në një repart të kancerit, ku shoqëroja nga ana psikologjike pacientët që ishin buzë vdekjes.

Isha shumë kurioze dhe e interesuar të di se çfarë do të kishin lënë amanet për ne të “gjallët”, pacientët që po e lënin këtë botë...

Nuk di a ishte një lloj impulsi për ardhmërinë time, por unë dëgjoja gjithmonë të njëjtat pendime se shumica ishin të penduar dhe të mërëzitur që nuk kanë pasur guxim t’u qëndrojnë besnik ëndrrave dhe vizioneve të tyre, por kanë zgjedhur jetën që të tjerët kanë pritur prej tyre.

Dhe, kjo ishte shumë reale, sepse





edhe mua më mungonte guximi. Unë, në të vërtetë, isha rehat në zonën time të komfortit, por prapë vizioni im më pëshpëriste se tani nuk mund të thuash "Sikur t'isha djalë". Tani ose do të fillosh të rrezikosh e që mund të shkatërrosh çdo gjë që ke ndër-tuar deri më tani ose do ta gëlltitësh ëndrrën tënde dhe do ta shkatërrosh veten.

Me gjithë frikën marramendëse dhe dilemat që kisha, mora guximin dhe i vazhdova studimet në Hamburg për Këshilltare të Psikologjisë.

Dhe, pasi i përfundova, hapa ordinancën time private dhe fillova nga zero.

Çuditërisht, kur ne i kthehemi esencës tonë dhe fillojmë të jemi ata që në të vërtetë jemi, atëherë ndodhin mrekullitë.

Unë, tash, në moshën 47-vjeçare, ndihem më e lumtur se kurrë dhe krenare që kam nisur udhëtimin tim, duke mbështetur shumë njerëz në rrugëtimin e tyre e duke qenë shembull për shumë femra, e në radhë të parë për vajzat e mia.

Andaj, asnjëherë nuk është vonë të fillojmë të sjellim në botë atë për çka

kemi lindur dhe të mos harrojmë se ne nuk jemi përgjegjës për bindjet dhe besimet tona si fëmijë, por si të rritur për riparim të këtyre bindjeve kemi përgjegjësinë qind për qind". Shkendija shton se ndihet shumë me fat që ka mundësinë që këtë frymëzim dhe motivim mund ta sjellë te bashkatdhetarët në gjuhën shqipe.

Ajo, po ashtu, është anëtare e Federatës së Mjekëve Shqiptarë në Evropë, këshilltare e lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrjetit Intelktual Shqiptar në Gjermani dhe, së fundi, shumë krenare që është femra e parë anëtare e Kryesisë së Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane në Gjermani.

"Paralelisht jam në studime dhe kërkime shkencore për krizën e viteve të mesme, e ashtuquajtura "Midlife Crisis", të cilën edhe e trajtoj si profesioniste.

Jam një femër shqiptare me vlera kombëtare dhe me një mision në kontributin e barazisë gjinore, gjë që është shumë më rëndësi për zhvillimin tonë si shoqëri që ka meshkuj dhe femra të jashtëzakonshëm dhe një rini të paparë".

Por, Shkendijen e vendosëm edhe para një pyetësi dhe ja si u përgjigj...

Si e kujton fëmijërinë?

- Fëmijëria ime ka qenë sa e mirë, në të njëjtën kohë jo edhe aq e lehtë, me faktin se unë isha fëmija i parë dhe pas meje edhe katër vëllezër e motra, të cilët kërkonin edhe kujdesin tim, shkak se mami (ndjesë pastë) punonte mësuese.

Kam filluar shumë herët të përballem me përgjegjësinë, që edhe sot jam falënderuese që ky virtyt më është kalitur nga vetë jeta në personalitetin tim.

Pak për vajzat tua?

- Gjithmonë janë në radhë të parë vajzat e mia, pasi që edhe ndodhen në një moshë delikate, edukimi i tyre për rëndësinë e familjes dhe ruajtjen e gjuhës shqipe, shkak se në Perëndim nuk është gjithmonë e lehtë.

Na fol pak më shumë për Unionin dhe pozicionin tënd aktual?

- Qëllimi i Unionit të Bizneseve është krijimi dhe fuqizimi i rrjetëzimit për

kompanitë dhe institucionet gjermano-shqiptare, si një urë lidhëse në promovimin dhe zhvillimin ekonomik, po ashtu social në relacionin ndërmjet mërgatës dhe viseve shqiptare, si dhe krijimi dhe mbajtja e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të Unionit në Gjermani.

Ndërsa, unë, që nga dhjetori i vitit 2022, jam emëruar anëtare e Kryesisë së Unionit të Bizneseve, ku edhe jam shumë mirënjohëse dhe, njëkohësisht, krenare, meqë jam edhe femra e parë në Kryesi pas një dekade.



Sa mendon se janë të integruara femrat shqiptare në Diasporë?

- Duke pasur parasysh potencialin dhe kapacitetin e femrës shqiptare, mendoj se kemi nevojë për një progres në integrim, gjithashtu edhe një mbështetje nga gjinia e kundërt. Femra shqiptare në Diasporë nuk shpalosë as gjysmën e kapaciteteve që posedon.

Ju, konkretisht, çfarë bëni për integrimin, avancimin a motivimin e femrës shqiptare në Diasporë?

- Përpos angazhimit profesional në motivimin, frymëzimin dhe mbështetjen e femrës, unë nga muaji mars do të filloj me mbajtjen e seminareve për rritjen e zhvillimit personal. Po ashtu, qëllimi kryesor në kyçjen në UB-ve ka qenë mu rritja e avancimit për pjesëmarrjen e grave në botën e biznesit në Gjermani, me faktin se shumë femra kanë bizneset e tyre dhe janë shumë të suksesshme. Gjithashtu, planifikojmë që në kuadër të UB-ve ta rrisim bashkëpunimin me femrat afariste nga trojet shqiptare, duke u krijuar mundësi për avancimin e bizneseve edhe në Gjermani.

E, përtej punës?

- Jam e martuar që 26 vjet. Jam nënë e dy vajzave: Leonites (21 vjeçe) dhe Lorenes (12 vjeçe). Kam ordinancën time private dhe, njëkohësisht, mbështes bashkëshortin në biznesin e tij. Nuk e di nëse mund të them që jam edhe afariste e mirë. Nuk është se më pëlqen të flas për veten time, pasi veprimet tona flasin më shumë se fjalët tona, por qëllimi ynë ndërton më shumë se të dyja së bashku.

Pasionet tua?

- Harmonia dhe krijimi i saj në marrëdhëniet ndërnjerëzore, sidomos në ato bashkëshortore dhe familjare, mandej studimi i komunikimit, si dhe rëndësia e tij në shoqërinë tonë, duke vazhduar

me filozofinë, psikologjinë e njeriut dhe spiritualitetin.

A jeni e mirë në kuzhinë?

- Po, konsideroj se jam kuzhinieri dhe nikoqire shumë e mirë dhe gatuj me shumë dëshirë e pasion, sidomos kuzhinën tradicionale.

A të mungon diçka?

- Po, më mungon dashuria e pakush-tëzuar që kam marrë nga mami im, e cila që gjashtë vjet nuk është në mesin tonë.

Gjëja më e bukur në jetë?

- Vetë jeta, si dhurata më e bukur, e mbështjellë me dashuri e shëndet.

Mesazhi yt?

- Mesazhi im, e që dua ta përcjellë, bazohet në thënien e Naim Frashërit se "Kombi që humb vetëdijen për të kaluarën e tij, gradualisht humb edhe veten e tij".

Kështu, guximi dhe vlerat tona shekullore, e që mua, fillimisht, më kanë sjellë këtu ku jam, por dëshira ime do të ishte që edhe në të ardhmen të kem mundësinë të jap maksimumin në mbështetjen e gruas, e, po ashtu, edhe të burrit, që së bashku të jemi të fortë dhe të arrijmë progres të denjë në shoqërinë tonë.

E, që vizioni im të marrë fuqi, duhet të jenë të dy duart të barabarta për të përkundur djepin dhe fatin e shoqërisë, duke ndërtuar vetëdijen kolektive, ku, së bashku, mashkulli dhe femra janë ata që ndërtojnë ardhmërinë e një populli.

Nderim Neziri



FRIGO DELUXE SOLUTIONS



UB



UB- ura bashkëpunimi me ndërmarrjet nga Kosova që target kanë edhe tregun european

Unioni i Bizneseve (UB) po punon të krijojë ura bashkëpunimi me ndërmarrjet nga Kosova, të cilat target kanë edhe tregun European.

Në vazhden e krijimit të këtyre urave të bashkëpunimit, ishte edhe vizita e Kryetarit të UB, Nazmi Viqa, së bashku me anëtarin e Kryesisë dhe drejtorin

e financave, Vllaznim Kelmendi, te Kompania Frigo Deluxe, me pronar Burim Kuraja.

Kompania Frigo Deluxe e cila ekziston që nga viti 2016, është e fokusuar të ofroj pajisje dhe shërbime inovative në industrinë ushqimore.

Pajisje Profesionale për Kuzhina Industriale dedikuar për Hotele, Restorane, Bare, Pastiçeri etj

Krahas tregut lokal, synim të vazhdueshëm ka edhe tregun european, ku aktualisht exporton rreth 10% të këtyre produkteve dhe shërbimeve.

Unioni i Bizneseve do të krijoj ura lidhëse bashkëpunimi të ndërmarrjeve të sukseshme nga Vendlindja me ato Kompanitë anëtare të saja në Gjermani.

Suksesi krijon lidhjet!



KONTRIBUTI I NËNËS PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE SHQIPTARE

Gruaja është:

- Shpirti i shtëpisë
- Nëna e fëmijë
- Zonja e shtëpisë
- Kreu (nëna) i njerëzimit.
- Gruaja është themel i moralit shoqëror, nyje e shenjtë e cila mbjellë dashuri ndërmjet njerëzve. Kur ajo lihet pas dore vuan tërë shoqëria njerëzore.

(Haki Stërmilli)

Nëna është e pazëvendësueshme dhe atë nuk mund të zëvendësojë askush. Ajo mund t'i zëvendësojë të gjithë.

(Ismail Kadare)

Gjatë të kaluarës historike nëna shqiptare ka luajtur rol të rëndësishëm në mbi-jetesën e popullit shqiptar. Ajo, jo vetëm që u kujdes për familjen, rritjen dhe edukimin e fëmijëve, por ka kryer edhe shumë punë të tjera. Në mungesë të bashkëshortit, i cili shpesh mungonte nga shtëpia, se merrte pjesë në luftëra e kryengritje të shumta, në shërbimin ushtarak, e që ishte shumë i gjatë dhe larg atdheut, në punët në kurbet etj., ajo jo vetëm që ishte besnike ndaj tij, por edhe kujdesej dhe i rriste fëmijët e saj, por edhe për mbijetesën e familjes, duke u marrë me punë të shumta, madje edhe ato fushore, punëdore etj.

FEMRA SHQIPTARE NË MBROJTJE TË ATDHEUT

Femra shqiptare, në shumë raste, me armë në dorë luftonte për mbrojtje të atdheut dhe të pragut të shtëpisë. Femra shqiptare ishte dhe është krenaria e popullit. Ka shumë raste kur femra shqiptare krahe për krahe me burrin luftonin për liri e pavarësi.



"Shqiptarja", gazeta "Srpska Zora",
Vjen, 1.2.1876.

Po fillojmë me një shkrim të një gazete të botuar në Vjenë, më 1 shkurt 1876, me titull "Shqiptarja", e ku, në mes të tjerash, shkruante:

"Femrën, sipas shikimit të saj krenar dhe sipas ecjes së sigurt, do ta njohësh nëse është e dashura, motra apo nëna e atyre trimave të patrembur. Edhe shqiptarja mban revole dhe pas saj shkojnë sharovë të tmerrshëm. Ajo, në rast të ndonjë fyerje, nuk e thërret mashkullin, hakmerret vetë. Kuptohet, fëmijët nga ato nëna nuk janë qyqarë.

Shqiptarja nuk mbulohet me vel, fytyrën e saj ajo më së miri e ruan vetë. Bukuria e saj është e njohur dhe mund t'u shërbente si model piktorëve grekë. Ka sy të mëdhenj, të zinj që shndrisin si të lëshonin shkëndija, ka hundë të lakuar, flokë të gjatë ngjyrë gështenjë, fytyra e saj lehtësisht e zeshkët është e butë, ka ecje elegante, ndërsa duart e saj janë të vogla.

Mirëpo, ajo bukuri e jashtëzakonshme shpejt kalon. Shqiptarja qysh në moshën 14 vjeçe bëhet grua e shpesh edhe nënë. Porse, ajo fatin e vet nuk e kërkon në bukuri, veç në kënaqësinë e vet, të burrit dhe të fëmijëve të saj.

E ndershme dhe besnike është shqiptarja, ndërsa për trimëri nuk ia lëshon udhë as malaziasës, e po filloi lufta për çlirimin e rajës turke në pranverë – do të ngrihet edhe shqiptarja "që t'u heqë pluhurin pushkëve të vogla", ku duhet burrin luan ta zëvendësojë dhe të hakmerret!"

REFORMA AGRARE E DETYROI GRUAN SHQIPTARE NË KOSOVË TË GJEJË MJETE PËR EKZISTENCËN E FËMIJËVE TË SAJ

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore në Kosovë është zbatuar e ashtuquajtura reformë agrare, ku toka iu merrte pronarëve shqiptarë dhe u jepej kolonëve sllavë të sjellë nga viset e ndryshme të Mbretërisë SKS, përkatësisht jugosllave.

Qëllimi i kësaj ishte serbizimi i Kosovës, duke bërë ndërrimin e strukturës nacionale në viset e Mbretërisë jugosllave në dëm të shqiptarëve, duke i detyruar që ata të shpërngulen nga atdheu i tyre në Turqi

e gjetiu.

Shqiptarëve u merrej toka deri në prag të shtëpisë, u merrej mjete kryesor për ekzistencë. Si pasojë e kësaj pësoi tërë familja, përkatësisht popullata shqiptare.

Në një dokument arkivor që ruhet në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, i vitit 1937, dosja 126, pas marrjes së tokës familjeve shqiptare nga pushteti i Mbretërisë jugosllave, edhe jeta e gruas shqiptare në Kosovë ndryshoi, ku, në mes të tjerash, shkruan:

"Sot jeta e saj është e padurueshme. Sot reforma agrare e ka detyruar gruan shqiptare në Kosovë të gjejë mjete të tjera për të siguruar ekzistencën e fëmijëve, sepse toka iu ndahej atyre që nuk kanë nevojë, as që mund ta punojnë (kolonëve sllavë të cilët as që e punonin J. O.).

Detyra e parë e saj ka qenë pastrimi dhe rregullimi i shtëpisë dhe rritja e fëmijëve. Ajo nuk ka ditur se çka është kujdesja për bukë dhe veshje. Burri i saj, i cili ka qenë bujk, tani nuk dinë se çka të bëjnë dhe çka të lëvrojë. Tokën ia kanë grabitur, kështu që gruaja është e detyruar të kërkojë mjete të tjera për të fituar kafshatën e gojës, sepse fëmijët donë bukë.

Një kohë veku i gruas shërbente për të përgatitur çejzin e vajzës, motrës, por tani punon pëlthurë për të shitur. Por, edhe kjo shitje nuk i plotëson as nevojat elementare të shtëpisë.

Sot në Kosovë gruaja nuk shkon të dëfrehet sikurse më parë. Ato tubohen dhe i ankohen njëra-tjetrës. Sidomos ankohen kur burrit i merrej toka, atë copëz tokë që e ka punuar dhe e ka pasur si burim të jetës. Tani burri punëtor ka mbetur duarkryq.

Në Kosovë nuk dëgjohet më asgjë tjetër përveç vajtim për tokën e grabitur. Toka merrej, e shqiptari, shqiptarja, fëmijët e tyre dhe të gjithë të tjerët thërrisnin: U fikëm, po vdesim me mundimet e të ashtuquajturës grabitje nga reforma agrare".

Marrjen e tokës dhe dhënien kolonëve e dëshmojnë shumë dokumente. Në një dokument shkruan se Stacioni i xhandarmërisë në Landovicë të Prizrenit, me shkresën nr. 680, datë 7. VI. 1936, e njofton Prefektin e Rrethit të Sharrit, përkitazi me këtë:

"... Kolonët, të cilët e kanë marrë tokën në kompleksin "Tupec", janë marrë në mbrojtje nga ana e këtij stacioni sa është e mundur. Mirëpo, shumica e këtyre kolonëve ia kanë



Ilustrim - Krimet serbe në Kosovë që nga viti 1912 e tutje

dhënë tokën shqiptarëve që edhe më tutje t'ua punojnë përgjysmë me marrëveshje të ndryshme, ndërsa disa sish gjenden nëpër Serbi dhe Mal të Zi, në shtëpitë e tyre, në vend se ata vetë ta punojnë tokën që e kanë marrë.

Pastaj, ka raste të tilla që disa nuk ishin personalisht të pranishëm me rastin e dhënies së tokës, kështu që, madje, nuk dinë as mezhdat e vërteta të parcelave të veta..." (ASHP, F. Gjyqi i Rrethit Prizren, k. 3, KPS-303-1936).

Gruaja shqiptare, në shumë raste, konfrontojmë me organet e pushtetit serb, të cilët në forma të ndryshme uzurponin jo vetëm tokën, por edhe shtëpitë e pronarëve shqiptarë.

Sipas një dokumenti të provinijencës gjyqësore, datë 11 shkurt 1937, Prishtinë, nr. KK 657/35, organet policore kanë shkuar në fshatin Budrikë të Poshtme të Moravës së Epërme, me qëllim të marrjes së shtëpisë së Sadri, Beqir dhe Ramadan Musliut dhe dorëzimit serbit Jovan Dishlakoviçit.

Pronarët e shtëpisë kundërshtojnë. Patrulla policore i lidhin dhe i keqtrajtojnë. Aty afër ishte Havushja, gruaja e Bajram Shabanit, nga Budrika e Poshtme, e cila i sulmon policët dhe i godet me dru. Organet gjyqësore i padisin, duke përfshirë edhe Havushën dhe i dënojnë.

EDHE PSE SHQIPTARËT I DETYRONIN TË SHPËRNGULESHIN

NË TURQI, NËNA SHQIPTARE E KOMPENSOI ME LINDJEN E FËMIJËVE

Popullata shqiptare për shkak të dhunës e terrorit në masë të madhe ishte shpërngulur në Turqi. Mirëpo, organet e pushtetit serb në vitin 1935-1937 bëjnë analizën se sa kanë arritur që të realizonin projektin e tyre – serbizimin dhe kolonizimin e Kosovës me elementin sllav dhe shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, Shqipëri e gjetiu.

Si pasojë e pastrimit etnik afatgjatë dhe kolonizimit të hapësirave shqiptare, ka ardhur deri te ndryshimet në strukturën etnike të popullatës së Kosovës dhe trevave tjera shqiptare.

Megjithatë, edhe përkundër tërë kësaj, për shkak të natalitetit të lartë të popullsisë shqiptare, në Kosovë e në Maqedoninë Perëndimore, shqiptarët mbetën në shumicë (çka edhe pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë së këtyre trevave rritet për 2% në periudhën 1921-1931).

Kjo rritje e popullsisë është falë nënës shqiptare, e cila ishte heroinë e vërtetë e kohës. Ajo, përkundër vështirësive në rritjen e fëmijëve, punëve shtëpiake, trysnive nga pushteti, arriti që me lindshmërinë e saj deri diku të kompensojë numrin e popullatës së shpërngulur. Përkritazi me këtë, nacionalisti dhe ideologu serb Vasa Çubrilloviç, thotë se - *Neve na ka mundur nëna shqiptare (Pobedila je nas arnautska majka).*

Dhe, duke parë se kolonizimi me elementin sllav dhe shpërngulja e shqiptarëve nuk po jep rezultatet e duhura, sipas dëshirës dhe mendimeve të qarqeve borgjeze sunduese, në këtë drejtim të gjitha ministratë shtetërore të Mbretërisë jugosllave dhe organet e tjera u angazhuan edhe më tepër në intensifikimin e serbizimit dhe kolonizimit sllav të Kosovës dhe të shpërnguljes së shqiptarëve. U hartuan shumë plane e projekte konkrete.

Në konferencën ndërministrare, përkritazi me shpërnguljen e popullatës me prejardhje joslave nga e ashtuquajtura Serbi Jugore, të mbajtur më 1 tetor 1935 në Beograd në Ministrinë e Punëve të Jashtme, u diskutua edhe për angazhimin rreth shpërnguljes së shqiptarëve, lidhjes së një marrëveshjeje me Turqinë etj. Në këtë Konferencë u nxorën këto konkluzione:

1. Shpërngulja duhet të rregullohet sa më parë me konventë speciale me Turqinë dhe Shqipërinë;
2. Nëse me Shqipërinë nuk mund të lidhet marrëveshja dhe shtetasit tanë nuk dëshirojnë të shpërngulen në Turqi duhet bërë këtë:

- a. Shpërnguljen graduale të popullatës me prejardhje shqiptare e turke nga zona kufitare në brendësi dhe të kolonizohet ai vend me popullatë të nacionalitetit jugosllav;
- b. Këmbimi i popullsisë me Shqipërinë.
3. T'i bëhen lehtësime popullsisë e cila shpërngulet, si transporti, dhënia e pasaportave pa pagesë, lirimi nga taksat,

rekrutimi;

4. Të pamundësohet edhe të pengohet propaganda kundër shpërnguljes;

5. Zbatimi i rreptë i të gjitha dispozitave mbi kolonizimin e viseve jugore,

6. Nacionalizimi i emrave gjeografikë. (AJ B, Min. Poljoprivrede, 67, k. 1, f. 17).

Nga ato plane e projekte për shpërngulje po e përmendim dhe po i paraqesim disa elemente të Elaboratit voluminoz të Vasa Çubrilloviqit, me titull "Shpërngulja e Shqiptarëve", të 7 marsit 1937 (Arhiv Bivše Jugoslavenske Vojske, nr. 2, fas. 4, kut. 69; ASHK, XXVII/K. 2-31-1937), në të cilin, në mes të tjerash, thuhet:

"Siç thashë dhe më sipër, për ne është efektive vetëm shpërngulja masive e shqiptarëve nga trekëndëshi i tyre. Për t'u zbatuar një shpërngulje masive, kusht i parë është krijimi i një psikoze të përshtatshme. Kjo mund të bëhet në disa mënyra. Të gjithë e dimë se popullata myslimane, në përgjithësi, duke qenë naive, por edhe fanatike, shumë lehtë i nënshtrohet ndikimit, sidomos atij fetar. Me fjalë të tjera, për t'i shpërngulur shqiptarët, në radhë të parë, duhet ta bëjmë për vete klerin dhe parinë e tyre që kanë ndikim, qoftë duke u dhënë para, qoftë duke iu kanosur.

Sa më parë duhet gjetur agjitorë, të cilët do të agjitojnë për shpërngulje, e sidomos po qe se vetë Turqia do të pajtohej të na i dërgonte.

Mjet tjetër do të kishte qenë trysnia e aparatit shtetëror. Ai deri në skajshmëri duhet t'i vërë në zbatim ligjet, në mënyrë

që sa më tepër t'ua nxijë jetën shqiptarëve: gjobitje, arrestime, zbatimi i pamëshirshëm i të gjitha rregullave policore, dënimi i kontrabandës, i prerjes së pyjeve, ndjekja e njerëzve, lëshimi i qenve, angazhimi në punë angarie dhe çdo metodë tjetër që mund ta zbatojë në praktikë policia.

Në lëmin e ekonomisë të merren masat vijuese:

Të mos njihen tapitë e vjetra; puna në kadas-tra në të gjitha zonat të ndërprimit menjëherë; tatimet dhe të gjitha borxhet publike e private të grumbullohen pa mëshirë; të ndalohet shfrytëzimi i kullotave shtetërore dhe i kullotave komunale, të hiqen koncesionet, të merren lejet e lëshuara të punës për kafenetë, për dyqanet dhe për zanatet, të merren lejet e monopoli, të dëbohen nga shërbimet shtetërore, private dhe të vetad-ministrimit etj. Me masat e lartpërmendura shpërnguljet do të përshpejtohen.

Të zbatohen në mënyrë praktike dhe efektive edhe masat sanitare, si, p. sh.: të përmbarohet me dhunë çdo aktvendim edhe ndaj shtëpive; të rënohen muret dhe rrethojat e mëdha përreth shtëpive; të zbatohen me përpikëri masat veterinare me të cilat do të ndalohet nxjerrja e bagëtisë në tregje etj. Në çështjet fetare shqiptarët janë më të ndjeshëm, ndaj edhe në këtë sferë duhet të goditen mirë. Kjo mund të arrihet duke i shkaktuar probleme të ndryshme klerit, duke hapur rrugica nëpër varreza me qëllim përdhosjeje të tyre, duke e ndaluar poligaminë, e sidomos duke e zbatuar në mënyrë të pamëshirshme ligjin që edhe vajzat të

detyrohen ta ndjekin shkollimin fillor kudo që ka shkolla.

Në këtë drejtim mund të bëjë shumë edhe iniciativa private. Kolonëve tanë, varësisht nga nevoja, duhet dhënë armë. Në ato rrajone duhet të ndërmerren aksionet e vjetra të çetnikëve, ndërsa gjatë realizimit të aksionit ai të mbështetet në mënyrë sekrete. Për të shkaktuar konflikt masiv me shqiptarët në Metohi (Dukagjin J. O.), prej kodrave duhet lëshuar një valë malazezsh. Konflikti duhet të përgatitet me njerëz të besueshëm: sa më shumë që të ngrënë krye shqiptarët, aq më lehtë do të mund të shtrihet konflikti dhe ngjarja. Në mënyrë të qetë të prezantohet si konflikt i vëllazërisë dhe fisit dhe në rast nevojë t'i jepet karakter ekonomik.

Në instancë të fundit mund të nxiten edhe kryengritje lokale, në mënyrë që të shuhen në gjak me mjete më efektive, por jo aq me ushtrinë sa me kolonët, me fiset malazeze dhe me çetnikët.

Ekziston edhe një mjet të cilin Serbia në mënyrë tejet praktike e ka përdorur pas vitit 1878 - djegja sekrete e fshatrave dhe e lagjeve të shqiptarëve nëpër qytete".

Në "Elaboratin mbi Shqiptarët", botuar më 1937, autori serb Ivo Vukotiq, shkruan: "Në kombinimet tona politike dhe diplomatike dhe në politikën tonë ballkanike, gjithmonë kemi synuar të mënjanojmë të gjitha kërkesat shqiptare për krijimin e shtetit të pavarur, nga arsyeja e thjeshtë se ky shtet do të mund të krijohej vetëm kundër nesh dhe kundër aspiratave tona kombëtare.

Shqipëria, me vetë shtrirjen e saj gjeografike, është pengesë e zhvillimit ekonomik të Jugosllavisë". (Jusuf Osmani, Kolonizimi serb i Kosovës, Prishtinë, 2008, f. 133-134).

Ekzistojnë edhe shumë dokumente të tjera, plane, projekte e elaborate përkittazi me shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre arbërore. Aty shihet se janë përdorur të gjitha mjetet e dhunës dhe presionit kundër popullatës shqiptare. Ato ishin mjete që vështirë mendja e njeriut mundet t'i paramendojë.

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore u arrit që nga Kosova të shpërngulen mbi 240.000 banorë dhe të vendosen, sipas shënimeve zyrtare, mbi 67.400 kolonë. Sipas burimit tjetër, në periudhën e viteve 1919-1940, në përgjithësi janë dëbuar 255.878 myslimanë nga Mbretëria jugosllave në Turqi, nga të cilat shqiptarë 215.412, turq 27.884 dhe boshnjakë 2.582.

Përveç periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, shpërngulje të popullatës shqiptare të Kosovës ka pasur në masë të madhe edhe në periudhën e viteve 1912-1915, pastaj 1945-1966 etj. (Jusuf Osmani, Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941, Dokumente: Kolonizimi 1, Prishtinë, 2016, f. 92).

Jusuf OSMANI



Ilustrim - Shpërngulja e shqiptarëve të Kosovës për në Turqi

SUANITA

High End Luxury



SUANITA High End Luxury ofron produkie ekskluzive dhe unike nga të gjitha markat luksoze !

Parimi ynë mund të përkufizohet si:

MË E MIRA PËR MË PAK. Gjithmonë ofrojmë cilësinë më të mirë për çmimin më të mirë.

CILËSI E GARANTUAR. Ofrojmë veiem produkie të cilësisë më të lartë, premium në çdo detaj (imitim i klasës së parë 1:1)

Shikoni arrijet e fundit :

📍 Ferid Curri Prishtinë

📷 suanita_highendluxury

🌐 www.suanitashop.com



★ ★ ★ ★ ★
BREZOVICA
HOTEL & SPA



When snow falls
nature listens.



Flora Sadiku, e sukseshmja e fushës së estetikës në Austri



Flora Sadiku është rritur në Austri, meqë qëkur ishte tre vjeçe familja e saj migruan atje. Flora e ka kryer shkollën e mesme në degën e Ekonomisë, ndërkaq magjistraturën në Shpeditcion dhe Logjistikë.

Flora, pra, është një femër që ka investuar në arsimimin e saj të mirëfilltë.

Por, puna që bën sot nuk ka të bëjë fare me atë për çka ka studiuar...

“Flora Naqel & Wimperartist” - studio që po rritet

Si adhuruese e artit dhe estetikës, Flora vendosi t’i kryente disa kurse për manikyr, pastaj për mbjelljen ose zgjatjen e qerpikëve etj.

Sot është profesioniste e dëshmuar e fushës së bukurisë dhe estetikës dhe gama e shërbimeve të saj do të vazhdojë të rritet edhe më tej.

Në studion e saj “Flora Naqel & Wimperartist” shkojnë shumë kliente për të marrë shërbimet më cilësore nga Flora, e cila është e certifikuar për të gjitha shërbimet që kryen.

Studion e saj e bën të veçantë puna e pastër, produktet kualitative me të cilat punon, mirësjellja dhe komoditeti që ofrohet për klientet.

Tregon se në studion e saj, aktualisht, shërbimi më i kërkuar është zgjatja e thonjve - manikyri.

Flora është duke kryer masterin që të ofrojë edhe trajnime, ndërkohë që shumë shpejt pritet edhe zgjerimi i studios dhe spektri i shërbimeve nga fusha e bukurisë dhe estetikës.

Kjo femër punëtore, që ka arritur të ketë sukses në Austri, tregon se formulë suksesi për të është fakti se nuk ndalet së bëri më të mirën.

Studio “FLORA NAQEL & WIMPERARTIST” gjendet afër Salzburgut, më saktë në qendër të st. Johann im Pongau.





URIME PAVARËSIA E KOSOVËS



BOOM

*Cilët
këngëtarë tanë
u martuan
disa herë?*

*Cili
këngëtar yni
rrenë më së
shumti?*

*Gjërat
që duhet
t'i dini për
prezantueset
tona seksi*

Besiana Behluli,

*ylli që nuk ngjanë
me askënd*

*Miry Fox,
shqiptarja
që punon
frizere
për meshkuj,
fotografe
artistike
dhe ka një botë
të madhe*



Besiana Behluli, *ylli që nuk ngjanë me askënd*

Besiana Behluli është këngëtare me karakter fantastik. Imazhi i saj skenik bën diferencën, meqë është një “prerje” ndryshe në botën e muzikës shqipe.

Këndon live gjithandej, është shpirt artisti, por edhe femër e shkolluar e tejet e dedikuar ndaj obligimeve profesionale dhe të jetës në përgjithësi.

Dobësia e saj është e ëma, këngëtarja e madhe Shkurte Fejza. Moderne, pak avangarde dhe e prerë në art e jetë, kjo është Besiana Behluli, emër që nuk ka nevojë për prezantim të gjatë...

A është përgjegjësi e madhe të jesh vajza e një figure shumë të rëndësishme?

- Një krenari e pamatshme dhe një përgjegjësi e jashtëzakonshme. Janë 45 vjet karrierë dhe krijimtari me hite të pavdekshme, por dhe një figurë e pakontestueshme. Dhe, të gjitha këto duhet t'i mbash mbi supë gjithmonë dhe t'i mendosh para çdo gjëje që bën. Paralelisht duhet të mundohesh të krijosh dhe emrin tënd, të cilin është shumë vështirë nëse zgjedh të njëjtin profesion. Por, mbi të gjitha, kënaqësia që ndjen kur sheh admirimin dhe dashurinë e njerëzve për emrin e nënës është e papërshkrueshme.

A të kujtohet kënga e parë që ke kënduar?

- Po, më kujtohet, edhe pse kam qenë shumë e re, por emocionet e asaj dite ende i ndiej kur këndoj. Kënga e parë ka qenë "Rrotullojmë botën", të cilën e kam kënduar si pjesë e grupit "Xixëlonjat".

Kur kthehesh në fëmijëri, cila është gjëja më e bukur që e gjen?

- Imagjinata e pakufishme, kënaqësia të gjërat e vogla...

Po, në adoleshencë?

- Ndjenja se çdo gjë është e mundur.

Çka ke studiuar?

- Studimet Bachelor i kam kryer për Marketing, ndërsa ato Master i kam kryer MBA - Master in Business Administration. Dhe, të gjitha, që nga shkolla e mesme, i kam kryer në gjuhën angleze.

Ju ktheve sërish muzikës. Se nuk kishte si të ndodhte ndryshe, apo?

- Më shumë do të ishte çudi nëse nuk do t'i kthehesha...

Ke stil modern, pak avangard në skenë. Si është kultivuar kjo shije?

- Faleminderit për kompliment! Janë një sërë ndikimesh të kulturës perëndimore më shumë.

Jam rritur duke pasur një pasion për muzikën, artin dhe modën. Jam inspiruar edhe nga shumë yje ndërkombehtarë, por asnjëherë e kufizuar vetëm në një segment.

Shija ime është gjithëpërfshirëse për gjërat e bukura dhe të mirëfillta, e kjo mendoj se reflekton edhe në paraqitjet e mia.

"Tash jemi një", është sukcesi yt i fundit në muzikë. A prisje që do kishte gjithë këtë pëlqim?

- Jam shumë e lumtur që është pëlqyer. Kam marrë shumë mesazhe të mirë për këtë këngë. Kënga ka qenë dedikim për vëllanë dhe nusen e tij në ditën e tyre të dasmës dhe është bërë si një dhuratë për të dy. Mendoj se shumë çifte e kanë gjetur

veten në vargjet e mira të këngës dhe kjo më gëzon pa masë.

Dashuria është ajo e përbashkëta të të gjithë njerëzve, pavarësisht moshës, gjinisë dhe çdo diference tjetër.

Ke zgjedhur një zhanër krejt ndryshe nga ai i nënës dhe motrës, Gresës. Pse?

- Nuk ka qenë e paqëllimshme. Thjesht, mendoj se njeriu duhet ta provoj veten në shumë gjëra kur je në muzikë edhe në zhanre të muzikës, sepse asnjëherë nuk mund ta dish se cili të përshtatet më shumë.

Unë kam bërë edhe disa ripërpunime të këngëve shqipe.

Pra, nuk do të thotë se do të rri në atë zhanër që kam filluar.

A ke menduar, ndonjëherë, të këndosh këngë popullore?

- Po, kam kënduar edhe këngë popullore dhe këngë të vjetra shqipe. I këndoj, gjithashtu, edhe këngët e mamit. Jam rritur me muzikën popullore dhe e dua më shumë se çdo zhanër tjetër. Muzika popullore është ajo që na shoqëron në çdo festë dhe në çdo moment të rëndësishëm.

Prandaj, mendoj se muzika popullore është thesar i çmuar që duhet ta ruajmë e ta kultivojmë gjithmonë.

Ke këngë me Gresën. Po, me mamin a mund të ndodhë një duet?

- Kjo është një dëshirë shumë e madhe imja, mirëpo mendoj se duhet ta bëjmë një gjetje shumë të qëlluar, që të dalë një projekt i mirë, i mirëfilltë e komfor emrit dhe imazhit të nënës sime, Shkurte Fejzës.

Projekti i radhës?

- Një këngë shumë të mirë do e lansoj në pranverë.

Pyetësi 6 plus 6 me Besiana Behlulin

Dhurata më e bukur nga bashkëshorti?

- Një pikturë e punuar enkas me pamjen e vendit ku më ka propozuar.

Çfarë veture vozitë?

- Ekonomike.

Diçka që të bën nervoz?

- Puna që bëhet shkel e shko. Mendoj se kur e bën një punë, secili duhet të japë më të mirën e mundshme dhe jo për shpërbllim të jashtëm, por që i jep një përmbushje të brendshme. Fatkeqësisht, shumë herë shoh punë që bëhen pa dashuri, pa përkushtim. Është mëkat, sepse, përderisa po ia falë asaj pune kohën tënde, ia vlen ta bësh sa më mirë që mundesh.

Sekreti i bukurisë dhe linjavë?

- Yoga, ecje dhe nganjëherë fitnes. I kushtoj shumë rëndësi ushqimit, por nuk besoj në një regjim strikt. Mendoj se kujdesi i shëndetit fizik lidhet me atë mendor dhe të dyja janë esenciale për një jetë të mirë.



A do të hyje në "Big Brother"?

- Mendoj se hyrja në "Big Brother" është një rrezik shumë i madh, sidomos për mua, ku secila sjellje imja asociohet me emrin e nënës sime.

Nuk mendoj se njerëzit kishin qenë të gatshëm të më gjykonin mua si Besianë.

Gjithashtu, mendoj se është rrezik se si reflekton te audienca, meqë shumë gjëra mund të shtrembërohen dhe të nxirren jashtë kontekstit.

Nuk mendoj se po i shohim njerëzit të cilët kanë hyrë aty me të vërtetë si janë, sepse nuk e kanë ata në kontroll se cilit gjest apo fjalë të tyre po u jepet më shumë hapësirë dhe vëmendje jashtë. Mendoj se shumë personazhe aty janë të keqkuptuar nga jashtë, disa të gjykuar ashpër dhe disa të favorizuar pa meritë.

Kujt do i thoshe xhan?

- Bashkëshortit.

N. N.

Foto: Norik Uka

Cilët këngëtarë tanë u martuan disa herë?

Në Holivud ndarjet e çifteve të famshme janë të zakonshme. Lidhjet, fejesat e martesat atje sikur nuk janë të destinuara të zgjasin përgjithmonë. Madje, më shumë bën përshtypje një martesë që zgjat, sesa një ndarje që vjen shpejt.

Së fundi, edhe në Kosovë e Shqipëri po ndodhin ndarje e bashkime të furishme. Sot në krahët e dikujt, nesër të dikujt tjetër... Ja disa nga të njohurit tanë që janë martuar më shumë se një herë...

BLERO ME NJË, DY, TRI...

Aktual, i përfolur dhe me eksperiencë në jetë. Blero dikur ishte i fejuar me një bionde, me të cilën dukej tejet i dashuruar. Ata u ndanë pas një lidhje të gjatë. Tutje u fejua e më pas u martua me Teuta Krasniqin, me të cilën ka vajzën, Tarën.

Këngëtari më vonë u martua me bukuroshen Afrona Dikën dhe me të ka një fëmijë. Por, edhe me të u nda. Pas dy martesave të dështuara, këngëtari nga Mitrovica thuhet se tani ka rigjetur sërish dashurinë.

Vajza me të cilën tash është në lidhje thuhet se është shqiptare dhe jeton në Gjermani dhe nuk i përket jetës së shou-bizit dhe se romanca e tyre ka nisur gjatë verës.



AFRIM MUÇIQI JETON ME GRUAN E TRETË

Këngëtari i muzikës popullore ka thyer rekord në këtë aspekt. Ai ishte i martuar prej vitesh, por më pas hyri në lidhje me aktoren dhe këngëtaresh Emine Toskën, e pas shumë vitesh lidhje me të u bashkua me kolegen e tij Halime Manin.

Cili

këngëtar yni rrenë më së shumti?

Njëri prej këngëtarëve tanë më në zë (po e kursej të mos ia përmendi emrin se e njehë i madh e i vogël), e lë telefonin mbi tavolinë dhe hyn në tualet. Ndërkohë, telefoni i cingëron. I thotë menaxherit:

“Shih, bre, kush është!”.

“Qenka Izeti”, ia kthen menaxheri.

“Uh, bre, ku më gjet bash tash ai bërlllok! Hape telefonin dhe rreje diçka! Thuaj se jam diku... Kudo qoftë!”, i flet nga tualeti.

Dhe, kur menaxheri ia thotë Izetit fjalët e këngëtarit, ai e kupton se po e gënjen. Izeti pyet në sportel të hotelit se në cilën dhomë ndodhet ai, demek këngëtari...

E, kur ia mësynë dhomës së këngëtarit, pasi troket në derë, këngëtari ia hapë derën. Dhe, kur e sheh kush ishte, i bërtet menaxherit:

“Pse nuk më the se ishte Izeti, jarani jem! Mendova se është Izeti i Preshevës e atë nuk e kam në huj hiç!”.

Por, këngëtari, meqë e kishte në gjak rrenën, një ditë, kur edhe i vjen nga Zvicra një mik i tij dhe e thërret në telefon, i thotë miku se ka ardhur nga Zvicra dhe dëshiron ta takojë...

E, ai i përgjigjet me një qeshje të gjatë...

“Po, mirë që paske ardhur në Kosovë, por unë jam në Tiranë. Besa edhe gruaja nuk është në shtëpi. Ka tri ditë që është Stamboll. Unë kthehem nesër nga Tirana, kurse gruaja pas një jave dhe shihemi”, i thotë këngëtari. Por, nipi, i cili ndodhej afër gjyshit dhe e kishte dëgjuar bisedën e zhvilluar në telefon, i thotë:

“Gjysh, pse rrejte që nuk je në shtëpi?!”.

“Shuaj! Pasha gjyshin ti s’e di pse duhet me rrejt! Je ende i ri e mendon se nuk duhet të gënjesh, por kur të bëhesh sa gjyshi mësohesh edhe ti!”, ia kthen ai.

A close-up portrait of a woman with long, wavy, dark brown hair. She is wearing a black top and a light beige coat. She has a black choker necklace and a silver heart-shaped pendant necklace. Her right hand is resting on her hair. The background is a blurred, natural outdoor setting.

*Miry Fox, shqiptarja
që punon frizere për meshkuj,
fotografe artistike
dhe ka një botë të madhe*

Mirjeta, e njohur me emrin e artit Miry Fox, është lindur në Tetovë, ku ka jetuar gjatë vjet. Gjatë luftës, bashkë me familjen, janë shpërngulur në Shqipëri, afër familjes së nënës së saj, ku edhe e ka kryer klasën e parë.

“Pas dy vjetësh u transferuam në Itali, në rrethinën e Romës, ku qëndruam dymbëdhjetë vjet.

Në verën e vitit 2009, në moshën 14-vjeçare, e kam njohur atë që sot është burri im dhe bashkë me të, në vitin 2014, kemi ardhur në Gjermani, ku kemi krijuar edhe familjen tonë të vogël”.

Miry Fox është me profesion berbere, më saktë frizere për meshkuj, profesion të cilin e bën me mjaft pasion e përkushtim që nëntë vjet. Ndërkohë, një herë në javë ajo punon fotografe, duke realizuar fotografi artistike bebesh.

Mirjeta është femër multi-talente, pasi është edhe një makeup artiste e zonja. Madje, kjo ishte edhe puna e saj e parë në moshën 14-vjeçare. Për fotografinë ka mbajtur shumë kurse për të krijuar stilin e saj, e që është unik dhe ja njohin shumë njerëz.

Gjithashtu, është edhe njohëse e mirë e dixhitalizimit dhe fushës së dizajnit grafik, për çka aktualisht po punon për ngritjen e një biznesi rreth kësaj, e që në Instagram mund të gjendet si @miryfoxart “Fotografia hyri në jetën time në një periudhë të errët, ku doja të shpërqendroja veten dhe të fokusohesha në diçka që të mos mendoja për pjesën tjetër.

Dhe, zbulova se kam sy fotografik. Andaj, kjo rrugë që mora më solli vetëm gjëra pozitive”, thotë ajo, duke shtuar se empatia është fokusi i botës, është ajo që e ka përmirësuar jetën e saj dhe e ka motivuar shumë.

SHUMË E PRANISHME NË RRJETE SOCIALE

Miry Fox është e pranishme në rrjete sociale, meqë, sipas saj, rrjetet sociale janë mjete gjeniale nëse i përdorim në mënyrën e duhur.

“Aty mund të rritesh si person, si dyqan, si agjenci. Janë, sidomos, mjete perfekte për të shpërndarë profesionin, talentin dhe idetë që ke, ku mëson shumë nga të tjerët dhe të tjerët nga ti.

Mua Instagrami më ka motivuar shumë në çdo aspekt, nuk më ka interesuar kurrë numri i ndjekësve, por cilësia e gjërave.

Jam krenare për komunitetin e

vogël që kam ndërtuar”.

Mirjeta për Revistën tonë, “Kosovarja”, tregon se diçka pa të cilën nuk mundet është dashuria dhe të gjitha nuancat e saj.

“Nuk do të mund të jetoja pa shprehur dhe pa dhuruar të gjithë dashurinë e shumë të që kam, sidomos pa e ndjerë të njëjtën edhe unë.

Gjithçka është e parëndësishme pa dashuri”.


POROSIA E SAJ PËR FEMRAT

Porosia e saj për femrat është që të ecin gjithmonë me kokën lart, duke u bërë të pavarura.

Të kërkojnë një bashkëshort dhe jo një shef; të punojnë vetë dhe t'i realizojnë ëndrrat e tyre; mos ta kthejnë kokën prapa për ata që i bëjnë të ndihen të nënvlerësuar; ta kenë frikë veç Zotin e askënd tjetër dhe të luftojnë për të drejtat e tyre.

Të shtojmë se Mirjeta ka hapur edhe një faqe në Instagram, ku publikon vetëm aforizma dhe graza motivuese në gjuhën që e do aq shumë, në shqip. Faqja është (@mirysthoughts)

N. Neziri



Gjërat që duhet t'i dini për prezantueset tona seksi

LIBERTA SPAHIU

Liberta ka qenë modele që në moshë të re, ka luajtur në film. Ajo në botën e televizionit fillimisht u angazhua si prezantuese e motit, e tani është producente dhe prezantuese e "Prive"-së.

Babai i saj ka punuar profesor psikologjie. Është kunatë e ish-modeles së njohur, Diellza Bunjaku, e që është martuar me vëllanë e Libertes.

Ndonëse i ka bukur do vjet, Liberta duket si 18-vjeçare. Ushtron shumë në fitnes, bën tretman të ndryshëm, por ende pa asnjë operacion plastik. Pa dyshim, mban kreun e listës së prezantueseve më të bukura.



BLERONA ZEHIRI

Dikur ishte, thjesht, një adhuruese e të njohurve që i adhuronte dhe ëndërronte t'i takonte "live".

Babai i saj, duke parë dëshirën e madhe të së bijës për të qenë pjesë e televizionit, bëri krejt çka mundi që ajo të jetë aty ku donte.

Andaj, Blerona, ende pa i mbushur 13 vjeç, u bë pjesë e ekranit, duke prezantuar formate televizive për të rinj.

Asaj në moshë të re iu dha shansi të prezantonte përkrah Labit në "1 kafe me Labin".

Ka thënë se Labinot Gashi e ka ngritur profesionalisht, për çka i është falënderuese.

Tani prezanton emisionin "1 kafe prej shpisë" dhe po e realizon mirë.

Blerona komentohet edhe për format e saj fizike dhe humbjen e peshës...



allure[®]
B E A U T Y

JAMBER **F**



FILLERS



**Full Face
Rejuvenation**

Rruga "Rreshkit Collaku", Tiranë



Si e nxori gjarprin nga barku Hysen Aga?!

Jam kompleksuar. Ka kohë që e hapi rrjetin tim në "Facebook" me një dozë rezerve në mos e shoh si gjithnjë, që disa muaj, një grua kah vallëzon në dasmë... Si mundet gjithnjë duke vallëzuar?!

Gjithnjë i prinë valles, gjithnjë e hareshme! Ajo nuk pyet nëse ka ndodhur ndonjë vrasje apo nëse dikush ka ndonjë tragjedi familjare!

Befasohem kur më shfaqet ajo në telefon, e pas saj në faqet tjera njerëz që i shprehin ngushëllime ndokujt, njerëz që kujtojnë përvjetorë familjarësh e njerëz që shprehin lot për fëmijët e vdekur aksidentalisht.

Kisha bërë dy orë gjumë dhe, me t'u zgjuar, hapi portalet dhe nis të lexoj lajme nga vendi dhe bota...

Të vrarë në Ukrainë, të vrarë në Fushë-Kosovë e të plagosur.. Dhe, tamam dua ta shoh edhe "FB", ajo grua sërish në valle!

Nga inati e zbus arsyen për ta shikuar zonjën e hareshme, duke i prirë valles. Ajo, me siguri, nuk lexon asgjë.

Ajo, me siguri, nuk di që ka luftë në Ukrainë dhe se ajo luftë mund të na përpijë edhe neve, duke u zgjeruar me shpejtësi, ashtu siç po thonë tashmë

edhe gjeneralët amerikanë se jemi në prag të luftës së tretë botërore...

Ajo grua, me siguri, nuk di se po mbahet "Big Brodher" në Shqipëri dhe një tjetër në Kosovë.

As nuk di se këngëtari Luizi po bën manovra, por nuk di as për lëndimet që pos ia sjell Tijara!

Grua e veçantë mund të jetë kjo që nuk e përcjellë kohën tonë dhe lajmet në të cilat shkrepë gjithnjë nga një plumb, mendoj në vete.

E STUDIONTE RUSISHTEN, KURSE I URRENTE RUSËT!

Dhe, teksa mendoj se si mund të ketë kaq njerëz të hareshëm, më shfaqet ish-shoku i studimeve, tani në Itali me letra dhe me familje...

Nuk e kisha parë ndonjëherë nervoz, as të mërzhitur. Ai ka qenë i vetmi njeri që ka shfaqur gjithnjë buzëqeshje. E

studionte gjuhën dhe letërsinë ruse atëbotë, kurse i urrente rusët!

Banonim bashkë në konviktin e studentëve numër 4, që atëbotë ishte konvikti më i mirë, meqë ishte ndër-tuar i fundit në atë kompleks të qytetit të studentëve.

Bëheshin demonstrata studentore e ai qeshej!

E rrihte policia speciale federative e ai qeshej!

Më në fund, tha: "Unë jam kështu..."

Dukem i qeshur gjithnjë, por s'jam i tillë. Përbrenda jam i tëri vaj e lot, sepse jam rritur jetim".

KUR INATI KTHEHET NË DHEMBJE...

Dhe, kur sërish hapi "Faceboku-un" tim, për të parë postime të reja, ajo zonja përsëri në krye të valles...

Më duket më ka braktisur inati dhe ndjesia ndaj valles së saj dhe, them

me vete, ajo mund të jetë e tëra lot përbrenda...

Mund të jetë diçka e tillë që ajo nuk ndalet së vallëzuari dhe do nxjerrë nga barku i plasur, si në këngën për Hysën Agën, nga barku i të cilit kishte dal gjarpri pas nëntë vjetësh.

Hysën Aga ishte fejuar me një vajzë malësore.

Me t'u fejuar e kaplon një dergjë e rëndë dhe mbetet nën kujdesin e motrës së vetme.

Nëntë vjet sëmundje i kishte kaluar, duke e pritur vdekjen...

Një ditë, teksa dalin te kroi vajzat për të mbushur ujë, së fejuarës së Hysën Agës i thotë një vajzë: "Ti qe nëntë vjet nën unazë, pse nuk po tregon se të ka lënë i fejuari?!"

Ajo preket dhe i shkruan letër të fejuarit. I thotë: "Hysën Agë, o merrmë o lërmë se kanë filluar të tallen me mua vajzat e Malësisë!".

Dhe, letra bie në dorën e motrës së Hysën Agës. E, pasi e lexon, fillojë të qajë. E shikon të vëllanë në shtrat tek dergjej nëntë vjet dhe e mendon të fejuarën e tij me faqe të kuqe në bjeshkë dhe ia kris vajit.

Vëllai i thotë:

"Motër, ti nuk ke faj që qan, sepse je lodhur me mua duke më shërbyer qe nëntë vjet! Të ka ardhur koha e martesës, prandaj lërmë mua dhe fejuhu!"

Ajo i thotë:

"Jo, nuk dua martesë, por ka ardhur një letër nga e fejuara jote dhe po kërkon o ta marrësh o ta lësh, se po tallen me të shoqet, duke i thënë se të ka lënë i fejuari...".

Hysën Aga e kishte pasur një shok-vëlla dhe i thotë motrës: "Motër, shko te "vëllai" im dhe thuaji se unë nuk kam fuqi martesë, por sa e merr dikush tjetër të fejuarën time le ta merr ai!". I vëllazëruari i Hysën Agës bëhet gati dhe e cakton ditën e dasmës.

Kur vjen dita nusja ishte veshur me duvak, por që të hipte në qere kishte një kusht:

Kah të vjen rrugës, kah dera e

ish-të fejuarit, të ndalen dasmorët dhe ajo ta sheh ish-të fejuarin e saj dhe vendin ku e ka dhënë babai...

Dhe, kur arrin karvani i dasmorëve te shtëpia e Hysën Agës, nusja hyn në shtëpi që të çmallet me ish-të fejuarin...

E, kur e sheh se në ç'gjendje ishte, nis të qajë nga dëshpërimi dhe e mallkon martesën e saj të re. Por, në të njëjtën kohë, Hysën Agës i vjen të vjellë dhe nga goja i del një gjarpër dhe ngrihet në këmbë.

Në çast, nusja i thotë: "Hiqma duvakun Hysën Agë!".

Ai ia heqë duvakun dhe të dy bashkë dalin para dasmorëve dhe ua tregojnë ngjarjen, pas së cilës ajo nga ai moment do të jetojë me Hysën Agën.

Por, as Hysën Aga nuk i kthen duarthatë dasmorët, nuk i lëshon pa nuse...

E përgatit motrën aty për aty që të bëhet nuse e "vëllait" të tij...

KUR TYMI DEL NGA BARKU...

Shikoj lajme, ngjarje, drama, tragjedi...

Tema që mund të jenë si subjekt kiameti...

Si nuk mendojnë njerëzit përafërsisht njëjtë për tokën e vet në të cilën jetojnë, ushqehen?!

E, për ta shprehur këtë gjë më mirë, po tregoj për mixhën Tahir, që nis ta bëjë një stog sane me të birin...

Plaku mbi stog, kurse i biri ia hidhte sanën.

Xha Tahiri i thotë të birit:

"Rrotulloje tërfurkun kur e hedhë sanën lart!"

Djali ia kthen:

"Nuk është sanë!"

"E, çka është?!", i thotë plaku.

"Është barë i thatë", ia kthen i biri.

E, kur e pyesin në odë pse i tha i biri ashtu, ai përgjigjet: "Vetëm mos me thënë qysh them unë!".

Dhe, ec e mos e qit gjarpurin prej barku, si Hysën Aga?!

Safet Krivaça



Kush e meriton një përmendore në mes të Prishtinës më shumë se Ukshin Hoti?

Shumë anëtarë të familjes së ngushtë dhe të gjerë të Ukshin Hotit u likuiduan nga regjimi okupator serb dhe nga forcat e errëta (numrin e saktë le ta thonë të tjerët, sepse mua më tmerron, siç më tmerron edhe heshtja e shqiptarëve për këto krime), para, gjatë dhe pas Luftës Çlirimtare të Kosovës, e mes tyre është edhe vetë Ukshin Hoti, një nga figurat më emblematike të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, i cili, si rrallë ndonjë intelektual tjetër, e filloi hapur këtë betejë çlirimtare që nga viti 1981 dhe pa ndalur punoi e veproi për këtë ideal.

Akademik Abdulla Mehmeti



Sa përdoren prezervativët në Kosovë?

Ajo që dihet është e thjeshtë: prezervativi nuk mbron qind për qind, por kufizon mundësinë e infektimit dhe parandalon shtatzëninë e dëshiruar. Ç'thonë të anketuarit tanë në këtë temë?

**VERIMJA, 18 VJEÇE,
MATURANTE GJIMNAZI:
MË VJEN MARRE
TË FLAS PËR KONDOMA!**

- Në shoqërinë tonë kanë ngelur disa tabu, për të cilat nuk flitet haptazi. Për shembull, përdorimi i kondomit është një nga tabut për shqiptarët. Kështu, nëse njëri nga partnerët gjatë seksit kërkon mbrojtje me prezervativ, partneri tjetër e merr si ofendim dhe këtu fillon e keqja...

**TRIMI, 25 VJEÇ,
KAMERIER NË PRISHTINË:
KUR I THASHË
FARMACISTES A KENI
KONDOMA, AJO QESHI!**

- Masat mbrojtëse, në këtë rast kondomi, ka efekt 98 për qind. Kështu kam lexuar në njërin nga portalet tona. Por, sa përdoren te ne kondomët? Me siguri, shumë pak, për të mos thënë

fare. E, kjo flet për shqetësim të jashtëzakonshëm.

Megjithatë, për ta ruajtur veten dhe partnerin, mendoj se nuk është mirë t'i ndërrosh shpesh partnerët, sepse e rrezikon edhe veten.

Por, një rast në farmaci më shtyri të qesh. Kur i thashë farmacistes a keni kondoma, ajo në vend të përgjigjes ma dha buzëqeshje të ëmbël, e cila më dha të kuptoj shumëçka...

**FELONA, 24 VJEÇE, PUNËTORE
BUTIKU NË GJILAN:**

**ÇKA KA TË KEQE
NËSE BLEN KONDOM?**

- Mendoj se ende te ne njerëzit kanë turp të blejnë prezervativ. Unë mendoj se këtu nuk ka asgjë të keqe, por ka të mira, të cilat ta ruajnë shëndetin, ta ruajnë jetën. Por, te ne ende ka shumë gra e burra që nuk dinë çka është kondomi, prezervativi. Sepse, kondomi ka të bëjë me planifikimin e familjes. Sidoqoftë, kjo gjë nuk paraqet ndonjë

problem për mua, sepse para 5 vjetësh kam punuar në një organizatë të huaj, e cila në qendër të aktivitetit të saj ka pasur sensibilizimin e krijimit të familjes dhe, nga ajo kohë sa kam punuar atje, kam mësuar shumë.

**METUSHI, 31 VJEÇ,
JURIST NGA PRIZRENI:
KONDOMI TË MBRON
NGA INFEKTIMET**

- Nuk jam ende i martuar, edhe pse marrëdhënie seksuale me vajza kam pasur që nga koha kur isha në studime. Sidoqoftë, mendoj se kondomi është mjet i mirë mbrojtës nga shtatzënia e padëshiruar dhe nga infektimi eventual. Andaj, çka ka të keqe këtu?!

PËR FUND

Kondomi të mbron nga shtatzënia e padëshiruar, nga sëmundjet e ndryshme eventuale seksuale, nga AIDS-i e të tjera.

Diturie Haxhaj



Ass. Prof. Dr. **Berk Arapi**
Specialist i Kirurgjisë Vaskulare

4-5
SHKURT

LARGIMI I VENAVE VARIKOZE PA NDËRHRYRJE KIRURGJIKE

LARGIMI I VENAVE ME LASER

Procedurë që zgjatë vetëm **40 min** dhe kryhet nën anestezion lokal. Menjëherë pas procedurës ju lironeni për në shtëpi dhe vazhdoni aktivitetet normale



A ka në Kosovë më shumë qytetarë a katundarë?

Ka kohë që shumëçka më shtynë kah katundi: ajri, natyra, arat, fushat e livadhet pafund. Të gjitha këto janë shtytësit e jetës sime, që më qojnë andej për ajër të pastër e natyrë me pisha të gjelbëruara.

Disi ngopem me ajër kur shkoj në katund. Nuk më kishte rënë në mendje se kishte dhjetëra arsye që qyteti nuk më shkonte më për qejfi.

Në mëngjesin e së premtes, 17 janar, miku im kishte lexuar se diku në Evropë qenka miratuar një ligj, i cili ndëshkon pronarët për shkak të lehjes së qenve në mëngjes apo gjatë natës, që mund të jenë si shkaktarë të prishjes së gjumit.

Miku im ndan, gjithashtu, shqetësimet se në lagjen e tij në Prishtinë më nuk flihet nga lehja e qenve. Qentë tërë natën lehin dhe ulërijnë.

Dhe, përveç këtyre shqetësimeve, pronarët e qenve që i kanë në shtëpi, me të zgjuar në mëngjes i nxjerrin

në shëtitje dhe i ofrojnë të kryejnë nevojat nëpër shkallë shtëpie, dyer të lokaleve afariste, madje edhe të lokaleve ushqimore!

Dhe, mendja më rri te një grup qensh në lagjen "Mati 1", e që ulërojnë si ujçërit në bjeshkë.

E, një natë më parë, kur djali im u vonua nga qyteti, me gruan nuk fjetëm fare, duke qëndruar në ballkon e duke vëzhguar gjendjen nëse do ta sulmonin djalin qentë kah kthehej në banesë.

Dikur e telefonuam të mos vinte farë në shtëpi, por të flinte te shoku i tij, sepse ka kohë që qentë janë shumuar me të madhe, shkojnë në grupe të trimëruar dhe po ta gjetën hallin vaj halli për ty.

Në secilën lagje ka "banda" të qenve që "njihen" ndërmjet veti, sepse kur vjen ndonjë qen i panjohur për ta, i vërsulen dhe e kafshojnë...

Por, në lagjen ku e kemi Redaksinë, ku i kemi zyrat e punës, është një qen bardhosh i racës së madhe, që i mbanim moti kohë në katunde kundër ujçërve.

Ky qen e do gjumin, por nuk e lenë pronarët të flejë. E tërheqin zvarrë që ta shëtisin.

Në fillim e merr zonja e shtëpisë dhe e nxjerrë në shëtitje, pastaj e nxjerrë në shëtitje pronari i shtëpisë. Më pas e marrin edhe fëmijët e tyre dhe kjo i bie shkelje flagrante e të drejtave të qenve në Prishtinë.

E shëtisin aq shumë sa qeni lodhet dhe mezi pret të bie në gjumë...

NË KATUNDE MË NUK KA QENË!

E, për ta shmangur prishjen e gjumit po ia theri në katund. Por, nuk më paskësh rënë në mend se katundin mund ta kem dashur, ndër të tjerash, edhe për shkak të prishjes së rehatisë natën nga lehjet e qenve.

Në katund fle qetë. Nuk ka qen që ma prish gjumin. Sepse, katundarët janë qytetëruar më shumë se qytetarët. Nuk mbajnë më as bagëti, as qenë, as...

Rrallë kund sheh pula a ndonjë mace. Para mëngjesit, nga larg, dëgjohet ndonjë zë i lehtë gjeli, i cili më vë edhe më shumë në gjumë.

Pra, qetë, rehati, parajsë...


Andaj, katundarët janë civilizuar dhe nuk ka më as oda që i ndajnë gratë që ta burrat...

Sokol Murturi

ASSBAU



www.assbau-kosovo.com

 /assbaukosovo

Pse te ne ndodhin rrahje e vrasje çdo ditë?

“Djali rrahë nënën”, “Djali rrahë babën duke e shpëtuar nënën”, “Nëna e paraqet të birin në polici”, “Nusja e bën vjehrrën për spital”, “Vrau njëri-tjetrin pa asnjë faj!”, e tituj të tjerë na bie të lexojmë çdo ditë...

Para lufte Kosova nuk ka pasur ngjarje të tilla! Në vendin tonë ka pasur nder, fytyrë, mëshirë, e veçmas respekt ndaj prindërve dhe të moshuarve.

Kur isha fëmijë, ai që ishte lindur një ditë para tjetrit, kishte të drejtë t’i kërkonte vëllait a shokut t’i mbushte një gotë ujë, sepse ishte më i moshuar se ai.

Fëmija nuk ishte adet t’ia kthente fjalën prindit. Ai kishte për ta dëgjuar fjalën e tij dhe kaq ishte kjo punë.

Përfilleshin edhe amanetet pas vdekjes. Njerëzit shkonin në haxh për dikë tjetër, se ai që kishte vdekur nuk kishte pasur mundësi të shkonte gjatë jetës së tij. E, para se të vdiste e lente amanet që ta kryente dikush haxhin për të...

TË PAREHATSHMIT ZOTI IA SJELL VDEKJEN KEQ!

Para pak ditësh, në një ndejë, një kushëri i tregonte një miku se si po

vuan nga sëmundja një dajë i tij.

“E ka përfshirë sëmundja e keqe”, thoshte kushëri për ta quar deri në fund tregimin.

“Mos pyet, edhe trupi i është tharë, sepse ka mbetur qe sa vjet ratë. Ia kanë blerë shtratin rrotullues djemtë në Zvicër, por nuk po i ndihmon. I është zvogëluar edhe koka...”

Nuk po dinë çka të bëjnë me të. Bile, një njeri u ka thënë t’i prenë kurban dhe të drejtohet dika...

Po, vetëm se nuk ka qenë i rehatshëm. Kurrë nuk ka ditë me nderua babën e as nënën! Nuk ka bërë asgjë të mirë për askënd, andaj Zoti e ka dënuar me vuajtje”, ia lidhin kokën muhabetit.

Dhe, tek i dëgjoja kah flisnin, mendja mu kthye në fëmijëri të hershme, kur halla tregonte në odë si kishte vdekur babai i saj.

Më vinë në mendje fjalët një nga një, qysh i numëronte halla rend e pa ia

huq. Ishte e shenjtë, sepse ajo nuk frikësohej nga vdekja.

“Baba pak para se të vdiste po qëndronte nën hije të “Dardhës Ukere”. Dhe, qysh kemi qenë duke ndenjtur, baba ka thënë - qohu Resime e hymë brenda se më ka ardhur iza me vdekur.

“Jo babë, qysh me vdekur kaq i fortë ti?!” ia ktheva.

Baba më tha se edhe një muaj i mbushë 100 vjet...

“Po të tregoj pse po vdes kollaj: Kam bërë mirë dhe kam dhënë sa kam mundur. I kam rritur tri palë jetimë. Kam qëndruar 12 vjet burg në Turqi, në kohën e turkut dhe nuk ka pasur askush rreth meje që ka pasur guxim të mos e agjërojë ramazanin, deshi e s’deshi!

Këto tri sende më bëjnë ta dorëzojë lehtë shpirtin!”, ma ktheu ai.

Dhe, fill dha shpirt...

S. Krivaça



Contact- Reception - +38260008002
tel. +38269610003 +38269607865
hotel.continental.ulcinj@gmail.com

 /hotel_continental_ulcinj

Pa t'shti në dorë burri i fortë, femra nuk po u mbushke mend!

Pa t'shti në dorë burri i fortë, femra nuk po u mbushke mend kurrë... E, kur po e bejke këtë, femra po u qokua në orën 7 të sabahut me shumë dashni...

Përhëndetje! E di që shumë prej jush që do i lexoni këta rreshta keni me më sharë e me më ofenduar... Sidoqoftë, qëkur jam martuar s'kam ditur të ndalur prej britmës që ia kam bërë burrit tim. E, as nuk kam pasur respekt për të. Por, tash, pas katër vjetësh martesë, e kam kuptuar sa gabim e kisha pasur... Sidoqoftë, me burrin tim jam njof-tuar në një kafiq në Gjilan. Ishim disa shoqe e shokë. Ai erdhi dhe na u bashkua me një shok të vetin dhe filluam të bisedojmë...

NUK MA PRISHNIN AS VJEHËRRIA, AS KUNATAT E AS KUNETËRIT

Dhe, nga ajo ditë jemi takuar vazhdimisht. Në fillim kënaqeshim dhe

e kam luajtur rolin e femrës të urtë: vjehërria me ma prish jo, kunatat jo, kunetërit jo...

Andaj, s'kisha pse me u bë nervoz... Kështu, nuk zgjati shumë e burri më tha a fejojemi se mirë po kalojmë ndërmjet veti...

Erdhi te baba im, foli me të. Në fillim babës nuk i pëlqeu, por më vonë disi u zbutë...

Dhe, pas një viti u martuam. Por, qysh në javën e dytë pas martesës ma bëri kiamet. Më zgjonte në orën shtatë të mëngjesit që t'i bëja kafënë e mëngjesin.

Por, ç'është më e keqja, që nga koha e martesës sime kunatat (motrat e burrit), më shumë rrinë te ne se në shtëpitë e veta dhe a po do me u bë drekë, a po do me u bë darkë, a po do nga dy-tri herë me u bë çaj, e çka jo tjetër...

O BURRË, NUK JETOHET KËSHTU!

E, kur i thashë burrit se jam mërzitë nga to se po kam shumë punë, më tha: "Gjithmonë kanë me ardhur se i kam motra!"

Dhe, ma mbylli gojën me të parën... Por, unë përsëri s'ndalesha, duke i thënë që të vijnë sa më rrallë, se

mbarova duke punuar...

Mirëpo, një ditë, kur erdhi im burrë nga puna, e që ishte shumë i lodhur, kur ia thashë të njëjtat fjalë si përherë, më tha: "Shko në dhomë se po vij me menjëherë!"

E, pasi shkova në dhomë, nuk vonoi shumë dhe erdhi. Ishte mllefosur në mua. Më shtrëngoi për beli sa gati ma ndali frymën.

I thashë: "Mos më shtrëngo se po më zihet fryma!"

Më tha: "Këtë herë po të shtrëngoj, herën tjetër ta ndaj frymën krejt po bërë zë në shtëpi!"

Dhe, të nesërmen e thirra babanë në telefon dhe i tregova se çka më kishte ndodhur...

Ai e thërret tim burrë në telefon. Por, im burrë ia tregon të gjitha sjelljet e mia në shtëpi dhe babai i thotë mirë ia paske bërë...

SI U MBUSHA MEND?

Sidoqoftë, prej asaj kohe jam mbushur mend dhe po habiten të gjithë se si qohem herët në shtatë të mëngjesit e u bëj kafe e mëngjes dhe jam bërë për lakmi...

Elhamja, Gjilan



Kunata ulet përpara me burrin tim n'kerr e unë prapa!

Kunata ulet përpara me burrin tim n'kerr e unë mbrapa! Burri më thotë: "Je xheloze se kunatën e kam si motër!"

Jam grua e martuar. E kam burrin dhe dy fëmijë. Por, edhe një javë me folur për jetën time është pak! Prej se e njoha burrin tim gjithmonë kam qenë në gjendje me bënë çmos për të. I kam lënë kushtet e mira në shtëpi të babës dhe i jam përkushtuar me trup e shpirt burrit tim. Pas dy vjetësh e fejuar u martova, edhe pse im burrë ishte me kushte të vështira materiale. Kurrë nuk më qonte për kafe në ndonjë lokal, e lëre më shumë. E, ajo që më habiste ishte fakti se im

burrë sillej mirë me kunata dhe fjala e tyre qonte më shumë peshë sesa imja.

KUNATA NA NGJITEJ SI BIBER!

Dhe, sa herë që dilja me tim burrë për të shëtitur a blerë diçka, kunata na u lyente pas, na hynte në mes, s'na linte me u ulur pranë njëri-tjetrit, e në veturë unë prapa ajo përpara! Shpesh i thosha burrit çka ka kjo që nuk po na lë askund vetëm, e ai, si me qortim, më thoshte se jam xheloze... Madje, im burrë më thoshte shko ti te nëna jote dhe rri një javë, e unë, buallica, i hipja autobusit e drejt e te nëna... E, sa për atë punën që bëhet natën në shtrat me burrë të mos flasim, sepse ai as që donte të hynte kah puna e seksit. Madje, edhe kur bënim ndonjëherë seks, nuk zgjate më shumë se 5 minuta, sa për sy e faqe...

TAKIMI ME ISH-TË DASHURIN PAS 20 VJETËSH

Por, para se të njihesha me tim burrë kam pasur lidhje me një djalë. Më ka dashur shumë. Por, ai u martua dhe unë mbeta me kujtimin për të. Mirëpo, pas një kohe të gjatë, përafërsisht 20 vjet, rashë në kontakt me të. Ai ishte ndarë nga gruaja, por edhe unë nuk i kisha mirë punët me burrë. Dhe, nisa të takohesha me të... Sidoqoftë, gjithçka do ia falja burrit veç mos t'ma kishte plasur barkun me kunatën e vet... Po ashtu, po bëhen 11 vjet që nuk flemë në të njëjtin shtrat. E, edhe kur i shkoj në shtrat, për 5 minuta e kryen punën e vet e për mua as që brengoset se a jam kënaqur a jo... Pra, unë gjithmonë i dhashë dashuri e ai mua kurrë... Keq, a?

Esmirja, Ferizaj



Adresa: Ferizaj, rruga për Jezerc, km 3-të
Rezervoni në: +38346600044

 /thehillsrestaurant  /thehills1

Kur dhe pse na kujtohet dashuria e parë?

Dashuria e parë na kujtohet vetëm për mallkim!

Hera e parë nuk harrohet, sepse është përvojë e diçkaje të panjohur që e kemi bërë. Sidoqoftë, dashuritë që vijnë më vonë janë shumë më të fuqishme dhe lënë mbresa e kujtime më shumë se ajo e para. E para më shumë kujtohet për ndjenjën e frikës dhe eksperiencën e parë. Sepse, kur lindë dashuria tjetër, e para më shumë kujtohet për mallkim dhe urrejtje.

KUJT ISH-I DASHURI I KUJTOHET VAZHDIMISHT?

“Për të harruar dashurinë e parë, ndonjëherë varet nga përvojat që kemi pasur. Dikujt dashuria e parë mund t’i ketë dhënë shumë dhimbje ose urrejtje, prandaj ajo do t’i mbetet gjithmonë në mendje. Dikujt tjetër mund të mos i hiqet nga mendja pamja e personit që e ka dashuruar dhe i kujtohet vazhdimisht”, thotë Valmira, mësuese nga Prizreni.

NGA DASHURIA E PARË MË SHUMË KUJTOHET “LAMTUMIRA E FUNDIT”

“Lidhja e parë harrohet shpejt edhe nëse ka qenë me ndjenja, e mirë, e gjatë... Por, me pjekurinë e njeriut gjërat ndryshojnë: dashuritë e më

vonshme bëhen më serioze, më të fuqishme dhe e mundin atë herën e parë kur e ke bërë seftë. Sepse, mbahet mend vetëm personi, ndërsa ngjarjet kujtohen si nëpër tym, nëpër mjegull.

Dashuria e parë kujtohet, mendoj, në tre momente: takimi i parë, seksi i parë dhe, përfundimisht, lamtumira e fundit.

Personalisht, kur e kam parë në rrugë të dashurën time të parë pas pesë vjetësh nga ndarja, ajo ishte me një fëmijë për dore, pra ishte martuar. Në atë çast m’u kujtua takimi i parë, vendi ku kemi bërë dashuri për herë të parë, por edhe lamtumira e fundit”, thotë Iliriu nga Prishtina, tash i martuar dhe baba i dy fëmijëve.

E HUMBA VIRGJËRINË DHE HAJT...

“Dashuria e parë të kujton vetëm humbjen e virgjërisë dhe asgjë tjetër!

Tash e kujtoj vetëm për mallkim, sepse djaloshin që e doja arriti që në takim të parë të më zhvirgjëroj dhe pas një kohe u largua, sikur të mos kishte ndodhë asgjë!

Por, deshi fati dhe njoha një djalë tjetër, i cili, që nga momenti i parë kur i thashë se kam pasur të dashur dhe nuk jam e virgjër, arriti të më kuptoj dhe të më dashuroj sikur t’i isha dorëzuar plotësisht e virgjër.

Tash, shyqyr Zotit e kemi edhe një djalë dhe dashuria e lumtura jonë familjare sa po vjen e po shtohet”, thotë Hysnija nga Gjilani.

SI TA PËRMBYLLË KËTË SHKRIM?

Dashuria e parë është si rufeja: aty ku bien edhe djeg! Por, dashuria e jetës është ajo me personin që ke krijuar familje dhe të mirën e të keqen e ndanë së bashku.

Diturie Haxhaj

Revolucion në dobësim

Qendra e dobësimit "Shkenda Dubova" është ndër bizneset e vetme kosovare me qendra në dy kontinente të botës.

Përmes rezultateve konkrete e shumë të suksesshme të klientëve, dhe për shkak efektivitetit të kësaj teknologjie, qendra arriti zgjerimin edhe jashtë vendit. Qendrat e dobësimit Shkenda Dubova tani operojnë në: **Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë, Norvegji, Angli e Amerikë.**

Programi për humbje peshe është i testuar, verifikuar dhe certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare.



Në qendrat e dobësimit ofrohet shërbim i veçantë që ndodhë në disa procese, përmes aparaturave të teknologjisë më të re në këtë fushë. Përmes shërbimit të dobësimit, ofrohet djegia e kalorive, nxitja e metabolizmit, shkrirja e masës dhjamore dhe trajtimi i thellë te saj.

Humb
peshë

Detoksifikohu



Relaksohu

Balanco
shëndetin



Jemi martuar të dy, a do të bashkohemi në botën tjetër?!

Që nga viti 90 nuk më heqësh nga mendja. Jemi martuar të dy, por e di se kemi m'u bërë bashkë në botën tjetër. Arsyja pse po të shkruaj është se më lëndoi shumë ndarja dhe si njeri me ndjenja që jam dëgjoj këngë që kanë ngjashmëri me historinë tonë.

Sot dëgjova këngën me titull "Lutëm për ty!", nga këngëtari Sabri Fejzullahu. E, në fakt, edhe unë lutëm për ty, e dashur, që ti të jesh mirë...

Ndarja me ty më lëndoi shumë, më ndali në kohë, më solli shumë mendime dhe rrugë pa fund, por prapë të kuptoj e respektoj vendimin tënd, edhe pse, në fakt, unë e ti s'kemi faj asnjëri, sepse neve na hyri në mes mësyshi dhe lakmia.

Unë lutëm që ti të kthjellësh një ditë dhe të jesh mirë, sepse akoma të pres në heshtje dhe po që e shkruar do të të bëj më të lumturën e botës, sepse të dua.

Andaj, besoj se kur t'i lexosh këta rreshta do e kuptosh se kush jam,

përndryshe do e ruaj në arkivin tonë dhe do e lexojmë së bashku një ditë. Unë e ti ishim çift për mrekulli. Ishim si dy binjakë me një shpirt, sepse në bazë të historive tona dhe sfidave që kemi pasur më herët gjatë jetës, të gjitha na dërgojnë në pjesën ku vetëm shpirti binjak i përjetojnë.

E dashur, kështu ende vazhdoj të të quaj, sepse ti ishe gjithmonë për mua gjithçka dhe do mbetesh ashtu, e vendin tënd nuk dua ta zë askush.

Vendi yt është mbetur thatë në zemrën time dhe, fundja, më mirë ashtu sesa ta gënjej dikë kinse e dua, sepse nuk dashurohem dot në askënd.

Është disi e pakuptueshme për ata që s'e kanë përjetuar vetë, sepse ta dashurosh dikë me dekada, e ta presësh një ditë se do të vije, kjo rralëherë ndodhë.

Sidoqoftë, historia jonë daton nga vitet 90 dhe kemi pasur martesë të dy, e që na kanë dështuar.

Dhe, nëse je e mendimit të vëmë

përsëri kontakt, Unë jam i gatshëm, sepse ndjenjat e mia për ty gjithmonë ekzistojnë...

Andaj, jam i gatshëm të jap maksimumin që ta rikthejmë edhe një herë lidhjen tonë, por ka ende persona të ligë që nuk mund të na shohin teksa kënaqemi...

Pra, unë për ty lutëm për ty çdo natë kur bie të fle, sepse të dua...

Por, të lutëm, edhe ti mendo në mua, ani pse ke obligime ndaj fëmijëve tu...

E, unë, edhe sot të dua si në kohën kur ishim në konviktin e studentëve dhe gjithnjë të pres dhe nuk dua asgjë në botë po të jemi edhe një herë bashkë siç ishim në kohën e jetës studentore... Më mungon shumë dhe e vetmja ti je ajo që ma shëron shpirtin tim të lënduar!

Pres telefonatën tënde të ta dëgjoj zërin e ëmbël, sepse ti je ajo që posa i hapi sytë në mëngjes në mendje më sillesh ti dhe vetëm ti...

I yti përgjithmonë!



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Çfarë qëllimi ka ish-i dashuri im?

Jam vajzë, 27-vjeçare, jetoj në rrethin e Ferizajt.

E kam pasur një dashnor 7 vjet, por ai u martua me një vajzë që jetonte jashtë dhe ia ka bërë letrat...

Atij iu imponua martesë shkak i kushteve ekonomike dhe i gjendjes së rëndë familjare...

Para një kohe më është lajmëruar dhe më ka ofruar martesë, duke më premtuar besnikëri.

Jam pa tekst zonja magjistare! Jam e humbur prej kur ma ka thënë këtë gjë dhe nuk di: T'i besoj apo jo?!

Çka më preferon?

"E humbura"

Përgjigje:

Unë kam mendim negativ sa i përket ribashkimit tuaj me martesë.

Këshilla ime është ta gjesh fatin tënd. Mund të ndodhin shumë gjëra të pakëndshme nëse ju lidheni përsëri.

E para, ribashkimi juaj me martesë do të qonte në ndarjen e tij nga gruaja;

E dyta, është problem, pastaj, t'i mbetën letrat atij;

E treta, problemi më i madh është çrregullimi ndërfamiljar, që mund të krijojë situata juaj.

Këshilla ime është: Kërkoje fatin e ri dhe harroje atë person! Sepse, në kohën e duhur nuk të ka bërë zgjidhje, prandaj nuk e ke të sigurt as tani se do të të bëjë zgjidhje...

Pse nuk po mund të koncentrohem?

Jam vajzë, 28-vjeçare, nga Gjakova. E kam kryer fakultetin, por nuk ma merr mendja të punësohem, sepse nuk po mund të koncentrohem!

Gjithashtu, edhe vëllai e ka kryer fakultetin, por është mbyllur shumë në vete. Jetojmë vetëm me një rrogë të babait dhe nuk jemi mirë, por mundohemi t'ia dalim. Të lutem, çka po ndodh me ne? A kemi magji?

"E arta"

Përgjigje:

Në rrethanat tuaja sikur po i shpjegon ti gjërat, ka mundë-

si të keni magji në shtëpi dhe unë shoh se fjala është për magji.

Shoh se duhet ta hulumtoni një orman të vjetër me rrova që i keni në të, si të përdorshme. Kërkoj prej jush t'i nxirrni ato dhe në një xhep të një palltoje dhe këmishë do të gjeni diçka në formë trekëndëshi të mbështjellë. Hiqeni prej rrobave dhe hidheni në zjarr që të digjen dhe për dy javë keni për t'u kthjelluar në kokë dhe në trup dhe ka për të filluar shtëpia së funksionuari së mbari. Ty do të të largohet pasiguria, e vëllai do hapet në shtëpi për të qenë komunikativ dhe i dobishëm.

A do të bëhem gruaja e tij?

Përshëndetje motër magjistare! Jetoj jashtë Kosovës. Jam në lidhje me një person që disa vjet. Më ka premtuar dhe më premtonte se do të lidhet me mua përmes martesës.

E dinë tërë familja e tij që ai më ka mua paralelisht me bashkëshorten e vet, por nuk po e bën hapin e fundit drejt zgjidhjes së problemit. Për këtë shkak unë po ndihem tepër nervoze, pasi kam pritur dhe po pres që ai të jetë i vendosur.

E dinë të dy familjet tona, e edhe bashkëshortja e tij... Jam në hall të madh, sepse vitet po kalojnë dhe unë

kam mbetur në pritje.
Të lutem, më jep përgjigje...
“Pritja”

Përgjigje:

Para së gjithash, nuk ka grua që ia jep dikujt tjetër bashkëshortin e vet! Nuk po paragjykojmë në mënyrën tonë fetare, do të thotë në mënyrën islame, sepse kuranisht kjo të jep të drejtë ty dhe atij, por të drejtën e shkelë praktika dhe jeta. E tërë kjo më duket se ka një montim pas vetes. Mendimi i tij se do të të blejë shtëpi dhe të jetoni ndaras është vetëm imagjinatë e tij dhe asgjë tjetër...

Megjithatë, sugjerimi im është tërhiqur prej kësaj lidhjeje. Sepse, duke u larguar prej tij do të qetësohesh dhe do t'ia bësh vetes pullazin tënd e do jesh e lirë të jetosh jetën tënde pa implikime konfliktuale për të cilat nuk ke nevojë.

Kur do më buzëqesh fati?

Jam 42-vjeçare. Kam qenë e fejuar dhe e kam prishur fejesën. Thjesht, sikur më ke thënë ti ashtu më ka dal plotësisht, prandaj jam e prirë të të besoj për çdo gjë dhe çdo fjalë.

Sidoqoftë, qe një kohë të gjatë jam e vetmuar... Nuk di kur do më buzëqesh fati...

“A do më vjen fati?”

Përgjigje:

Në muajin gusht të këtij viti fati yt buzëqesh. Dhe, në

muajin shtator do martohesh. Personin që ta sjellë fatin jeton në Angli. Është i ndarë nga bashkëshortja dhe i ka dy fëmijë, të cilët jetojnë me ish-gruan e tij.
Urime dhe me fat!

Jam e martuar, e dashuroj një djalë të ri!

Jam 35-vjeçare. Besoj se nuk do më paragjykoni që jam dashuruar në një djalë, me të cilin kam pasur takime të shpeshta, kurse kohëve të fundit i kemi shpeshtuar takimet deri në masën e brengosjes.

Kam provuar dhe po provoj ta ndalë veten, por nuk po mundem.

Në anën tjetër, po frikësohem se do të zihem një ditë me të dhe aty do të jetë fundi im!

Dua të di: Çka sheh për mua?

“Anonimja”

Përgjigje:

Është një gabim tepër i madh që je duke e bërë, ndërkohë që je me burrin legjitim!

Thonë: “Djali lë një lugë mjaltë në gruan e huaj!”, që është mjaftueshëm për të shpërthyer belaja.

Normalisht, tërë jetën nuk mund ta fshehësh veten se je e dashuruar në dikë tjetër...

Ai e ka fatin e vet dhe lidhja juaj mund të të dëmtojë dy direkt, duke ta prishur jetën bashkëshortore.

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Pse nuk po mund të vendosi për asgjë?

E nderuara magjistare, jam vajzë, 24-vjeçare. Kam pasur dhe kam kërkesa për martesë, por nuk po mund të vendosi me askënd!

Nuk di pse e kam kështu fatin?!

Të lutem, më trego, çka është në pyetje?

“Leona”

Përgjigje:

Nuk është normale ta refuzosh ofertën që është për ty. E, cila është për ty, shembull? Oferta adekuate për ty është ajo që ai person që të kërkon ty ka përafërsisht të njëjtat rrethana shoqërore e sociale si ti;

Që ka përafërsisht të njëjtën moshë dhe që ka të njëjtën përgatitje profesionale, bile përafërsisht.

Megjithatë, shoh te ti pengesa dhe mirë që më je lajmëruar...

Në dhomën tënde, mbi ormanët e dhomës, me sa shoh, është një fasulet me pika gjaku. E, në të është një letër e kaltër.

Largoje nga dhoma dhe do të çlirohesh.

Dhe, brenda tre muajsh do e gjesh fatin dhe do të mbarojë kjo punë me fejesë...



SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels



SHERWOOD
exclusive kemer

SHERWOOD
exclusive Lara


SHERWOOD
Dreams Resort




SHERWOOD
Premio Hotel

GREENWOOD
Kemer Resort

GREENWOOD
Suites Resort

 [sherwoodresorts](https://www.instagram.com/sherwoodresorts)

 [greenwoodhotels](https://www.instagram.com/greenwoodhotels)

www.sherwoodhotels.com.tr

www.greenwoodhotels.com.tr